



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT SHKODËR

Nr. 1482/1 Prot
Dt. 11.04.25



Nr. 246/1
prot

Shkoder, më 8.04.2025

LËNDA: Mbi Vendimin e Këshillit të Bashkisë Vau Dejës Nr.20, datë 26.03.2025.

KËSHILLIT BASHKIAK VAU DEJËS

Prefekti i Qarkut Shkodër, në zbatim të detyrave të tij funksionale të përcaktuara në ligjin nr. 107, datë. 27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut” i ndryshuar, të Urdhërit të Kryeministrit Nr. 21, datë 05.02.2025 “Për detyrat e administratës së Prefektit të Qarkut”, të Urdhërit të MB Nr. 39, datë 20.02.2025 “Për miratimin e rregullores së brendshme për organizimin dhe funksionimin e Institucionit të Prefektit të Qarkut”, si dhe aneksin I “Rregullat për procedurat e verifikimit dhe kontrollin nga Prefekti i Qarkut”, ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, neni 18, 24, neni 54 germa k, neni 55/2, ligjit Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në RSH” neni 36 pika 1/c, VKM Nr.111/2018 “Per krijimin dhe funksionimin e fondit social”, shqyrtoi VKB Vau Dejës Nr.20, datë 26.03.2025 “Mbi miratimin e planit social vendor në Bashkinë Vau Dejës për 2025-2028”.

Prefekti konstaton se në mbështetje të ligjit Nr.121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë” neni 36 pika 1/c, Këshilli Bashkiak ka tagrin të miratojë një plan social vendor¹.

Për sa trajtuar, Prefekti ju autorizon të procedoni.
Duke ju falenderuar për bashkëpunimin,

PREFEKTI



¹ Sipas propozimit të organit ekzekutiv



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA VAU DEJËS
KËSHILLI BASHKIAK**

V E N D I M

Nr. 20 datë 26.03. 2025

“PËR MIRATIM E PLANI SOCIAL VENDOR 2025-2028, TË BASHKISË VAU DEJËS”.

Në mbështetje ligjin nr. 139 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë"; Ligji nr.10107/2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 8137/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” (FZ 20-1996) dhe Relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës,Këshilli Bashkiak:

V E N D O S I

1. Miratimin “Për miratim e Plani Social Vendor 2025-2028, të Bashkisë Vau Dejës”;
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite mbas shpalljes publike,sipas percaktimit te nenit 55,pika 6-të e ligjit 139/2015 datë 17.12.2015 “Për Vetëqeverisjen Vendore”i ndryshuar.

Kryetari Këshillit

Ervis Shimaj

Miratuar me 17 vota

Vota Pro 17

Vota Kunder -

Vota Abstenim -

Zbardhur me datë 02.04.2025

Sekretari Këshillit

Ardian Çelepija





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROJEKT VENDIM

Nr 08 datë 10.03.2025

“PËR MIRATIM E PLANI SOCIAL VENDOR 2025-2028, TË BASHKISË VAU DEJËS”.

Në mbështetje ligjin nr. 139 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.10107/2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 8137/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” (FZ 20-1996) dhe Relacionit të administratës së Bashkisë Vau Dejës; i propozojmë Këshillit të Bashkisë Vau Dejës, të :

VENDOSI

1. Miratimin “Për miratim e Plani Social Vendor 2025-2028, të Bashkisë Vau Dejës”;
2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Kryetari i Bashkisë.
3. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi:

Selma Baboni; Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve.

Miratoi:

_____: Drejtor/ Drejtoria e Mbrojtjes, Përfshirjes dhe Strehimit Social.

KRYETAR
Kristian Shkreli

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

ZV/KRYETAR

Aleksandra Gjoni

Konfirmoi Bazen Ligjore:

Çështjeve Gjyqësore

Enilda Treka Sektori i Asistencës Ligjore, Kontratave dhe



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA VAU DEJES

DREJTORIA E MBROJTJES, PËRFSHIRJES DHE STREHIMIT SOCIAL

RELACION

“PËR MIRATIM E PLANI SOCIAL VENDOR 2025-2028, TË BASHKISË VAU DEJËS”.

DREJTUAR : Këshillit Bashkiak Vau Dejës

Të nderuar Këshilltarë!

Në mbështetje të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë; Konventën për të Drejtat e Njeriut; Konventën për të Drejtat e Fëmijëve; Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara; Kartën Sociale Evropiane (e rishikuar); Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale; Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSh); Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit; CEDAW; Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2024-2030; Dokumenti i Përfshirjes Sociale 2024-2028; Plani Kombëtar i moshimit 2020-2024; Plani Kombëtar LGBTI+ 2021-2027; Plani Kombëtar për R&E 2021-2025; Agjenda e Fëmijëve 2021-2026 Plani Kombëtar i Veprimit PAK 2021-2025; Ligjin nr. 139 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar; ligji nr 121/2016 “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr.10107/2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”; Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”; Ligji nr. 8137/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” (FZ 20-1996), Bashkia e Vau Dejës ka detyrim të hartojë planet sociale vendore, për të siguruar mbështetje të qëndrueshme dhe efektive për grupet vulnerabël dhe për të përmirësuar shërbimet sociale në nivel lokal. Për këtë qëllim, në bashkëpunim me GOPAN dhe me mbështetje të Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, kemi vijuar punën për hartimin e Planit Social Vendor, duke përbushur kështu detyrimet ligjore të Bashkisë.

Ky plan është hartuar duke ndjekur një qasje të thelluar, të bazuar në të dhëna dhe konsultime të gjera me aktorët lokalë, për të siguruar një kuptim të plotë të sfidave dhe prioriteteve të Bashkisë Vau Dejës. Procesi i hartimit ka përfshirë disa hapa të rëndësishëm, të cilat i paraqesim më poshtë:

1. **Grumbullimi dhe analizimi i të dhënave relevante:** Të dhënat janë mbledhur nga Bashkia Vau Dejës, rregjistri i gjendjes civile, statistikat kombëtare dhe raportet e institucioneve të tjera relevante për të siguruar një analizë të plotë të situatës sociale.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

2. **Konsultime me aktorët lokalë dhe shoqërinë civile:** Janë zhvilluar konsultime me grupe të ndryshme të interesit, përfaqësues të shoqërisë civile, dhe grupe vulnerabël, për të përfshirë pikëpamjet e tyre në hartimin e planit.
3. **Identifikimi i boshllëqeve në shërbimet sociale:** Bazuar në raportet e monitorimit dhe përvojën e institucioneve vendore, janë identifikuar boshllëqe në ofrimin e shërbimeve sociale, të cilat duhen adresuar urgjentisht.
4. **Qasje pjesëmarrëse:** Komuniteti është përfshirë aktivisht në diskutime për të garantuar një përfaqësim të drejtë dhe për të zhvilluar politika sociale që janë në përputhje me nevojat e qytetarëve.

Ky plan është ndërtuar mbi një analizë të detajuar të situatës sociale në Bashkinë Vau Dejës, duke adresuar faktorët kyç si shkalla e varfërisë, papunësia, struktura demografike dhe aksesimi në shërbime sociale. Plani synon të plotësojë boshllëqet ekzistuese dhe të krijojë ndërhyrje të qëndrueshme për grupet më në nevojë.

Për të garantuar zbatimin efektiv të planit dhe për të monitoruar ndikimin e politikave sociale, është përfshirë një mekanizëm të qartë monitorimi dhe vlerësimi. Ky mekanizëm do të mundësojë ndjekjen e progresit dhe përshtatjen e ndërhyrjeve për t'iu përgjigjur nevojave emergjente.

Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Vau Dejës synon të krijojë një model të qëndrueshëm të mbështetjes sociale dhe të përmirësojë cilësinë e jetës për qytetarët e saj. Ky plan përfaqëson angazhimin e Bashkisë për forcimin e përfshirjes sociale dhe transparencës, duke ndihmuar në zhvillimin e shërbimeve sociale dhe përmirësimin e mbrojtjes sociale në nivel vendor.

Bashkia Vau Dejës ka për detyrë të vazhdojë të mbështesë dhe të zhvillojë këtë plan me qëllim që të sigurojë përmirësimin e kushteve të jetesës për të gjithë qytetarët dhe të kontribuojë në zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

Konceptoi:

Çuka Babani

Përgjegjësi i Sektorit të Shërbimit Social dhe Mbrojtjes së Fëmijëve.



Bashkia Vau Dejes

Plani Social Vendor
2025-2028

TABELA E PËRMBAJTJES

HYRJE	3
I. MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE	4
1. Vizioni	4
2. Misioni	4
3. Parimet e Planit Social Vendor	4
.....	5
II. ANALIZA E SITUATËS	5
1. Kuadri strategjik	5
2. Nevojat, shërbimet e ofruara dhe boshllëqet	6
Vlerësimi i nevojave	6
Të dhënat demografike	6
Të dhënat nga statistikat e mirëqenies dhe shërbimeve sociale	7
Ndihma Ekonomike për familjen në nevojë	7
Punëkërkuarët e papunë	8
Analiza e Punësimit dhe Formimit Profesional në Bashkinë Vau Dejës	8
Individë me aftësi të kufizuara	10
Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe/ose përkujdesje	12
Viktima të dhunës në familje	15
Individë/familje në nevojë për strehim social	16
Individë që kanë varësi nga alkooli	20
Individë që kanë varësi nga droga	21
Persona LGBTIQ+	23
Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve	23
Analiza e burimeve njerëzore	25
Analiza SWOT për realizimin e Planit Social Lokal në Bashkinë Vau Dejës	26
III. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT	28
IV. PLANI I VEPRIMIT	25
V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI	1
VI. ANEKSI 1 – TABELAT	2



Funded by
the European Union

Ky Plan Social Vendor është hartuar me mbështetjen financiare të Bashkimit Evropian. Përmajtja e saj është përgjegjësi vetëm e autorëve të tij dhe nuk pasqyron domosdoshmërisht pikëpamjet e Bashkimit Evropian.

Ky Plan Social Vendor publikohet nëpërmjet Asistencës Teknike “Mbështetjes së Bashkimit Evropian për Përfshirjen Sociale në Shqipëri” (EU4SI), të dhënë nga Bashkimi Evropian për Bashkinë e Vau Dejës, zbatuar nga GOPA Worldwide Consultants.

HYRJE

Bashkia Vau Dejës është një njësi e qeverisjes vendore e vendosur në veriperëndim të Shqipërisë, me një sipërfaqe prej **499, 09 km²** dhe një popullsi prej **19,261 banorësh sipas Cens 2023** (50,131 banorë sipas Rregjistrit të Gjendjes Civile). Bashkia përbëhet nga **6 njësi administrative** (Vau i Dejës, Bushat, Temal, Shllak, Hajmel dhe Vig Mnelë. Bashkia ka nën administrimin e saj një qytet dhe 47 fshatra. Bashkia paraqet një ekonomi të bazuar kryesisht në **bujqësi, blegtori dhe turizëm natyror e kulturor**. Ndryshimet demografike, shkalla e lartë e varfërisë dhe sfidat sociale të grupeve vulnerabël e bëjnë të nevojshme një strategji të mirëpërcaktuar për mbështetjen sociale dhe forcimin e mekanizmave të mbrojtjes sociale.

Plani Social Vendor i Bashkisë Vau Dejës **2025-2028** është një dokument strategjik që synon të adresojë nevojat sociale të qytetarëve dhe të sigurojë një sistem të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës të shërbimeve sociale. Ky plan është hartuar në përputhje me **kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar**, duke u mbështetur në analizën e situatës sociale, nevojat e komunitetit dhe rekomandimet e aktorëve lokalë dhe partnerëve institucionalë.

Në përputhje me **vizionin** e tij, Plani synon të krijojë një komunitet gjithëpërfshirës, ku çdo qytetar ka akses në shërbime sociale cilësore dhe mbështetje të nevojshme për integrim të plotë shoqëror. **Misioni** i tij fokusohet në forcimin e kapaciteteve të institucioneve vendore për të ofruar shërbime të integruara dhe të qëndrueshme, duke garantuar ndihmë dhe mbështetje për grupet vulnerabël.

Parimet kyçe mbi të cilat mbështetet Plani Social Vendor përfshijnë: i) **Përfshirjen sociale**, duke garantuar akses të barabartë në shërbime për të gjitha kategoritë në nevojë; ii) **Qeverisjen e mirë**, transparencën dhe pjesëmarrjen e komunitetit në hartimin dhe zbatimin e politikave sociale; iii) **Partneritetin ndërinstitucional**, duke përfshirë shoqërinë civile dhe sektorin privat për shërbime të integruara; iv) **Respektimin e të drejtave të njeriut**, duke siguruar akses të barabartë në shërbime pa diskriminim; v) **Zhvillimin e qëndrueshëm**, duke mbështetur masa sociale afatgjata dhe të bazuara në burime të qëndrueshme financiare dhe institucionale.

Ky plan është hartuar duke ndjekur një qasje të bazuar në të dhëna, konsultime dhe analiza të nevojave sociale, për të siguruar një kuptim të thelluar të sfidave dhe prioritetëve të Bashkisë Vau Dejës. Procesi i hartimit ka përfshirë:

- **Grumbullimin dhe analizimin e të dhënave** nga Bashkia Vau Dejës, rregjistri i gjendjes civile, statistikat kombëtare dhe raportet e institucioneve relevante;
- **Konsultime me aktorët lokalë dhe shoqërinë civile**, duke përfshirë grupet e interesit, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të komuniteteve vulnerabël;
- **Identifikimin e boshllëqeve ekzistuese në shërbimet sociale**, bazuar në raportet e monitorimit dhe përvojën e institucioneve vendore;
- **Përdorimin e një qasjeje pjesëmarrëse**, duke përfshirë komunitetin në diskutime për të garantuar përfaqësim të drejtë dhe zhvillim të politikave të përshtatura me nevojat e qytetarëve.

Plani është ndërtuar mbi një analizë të detajuar të situatës sociale në Bashkinë Vau Dejës, duke adresuar faktorë si shkalla e varfërisë, papunësia, struktura demografike dhe aksesimi i shërbimeve. Në këtë kuadër, dokumenti synon të plotësojë boshllëqet ekzistuese në sistemin e

mbrojtjes sociale dhe të krijojë ndërhyrje të qëndrueshme dhe të targetuara për grupet më në nevojë.

Për të garantuar zbatimin efektiv dhe matjen e ndikimit të politikave sociale, Plani përfshin një mekanizëm të qartë monitorimi dhe vlerësimi, duke mundësuar ndjekjen e progresit dhe përshtatjen e ndërhyrjeve sipas nevojave emergjente. Përmes këtij dokumenti, Bashkia Vau Dejes synon të krijojë një model të qëndrueshëm të mbështetjes sociale, duke rritur efektivitetin e politikave sociale dhe përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve të saj.

Ky plan përfaqëson një angazhim të qartë të bashkisë për forcimin e përfshirjes sociale dhe transparencës institucionale, duke vendosur një bazë të fortë për zhvillimin e shërbimeve sociale dhe rritjen e mbrojtjes sociale në nivel vendor.

I.MISIONI, VIZIONI, VLERAT DHE PARIMET UDHËRRËFYESE

1.Vizioni

Vizioni i këtij Plani Social është krijimi i një komuniteti ku të gjithë qytetarët kanë mundësinë të jetojnë me dinjitet dhe të marrin pjesë aktivisht në jetën sociale dhe ekonomike. Ky vizion përfshin krijimin e një sistemi shërbimesh sociale që është efektiv, i qasshëm dhe i drejtuar nga nevojat reale të komunitetit, duke promovuar barazinë dhe drejtësinë sociale.

2.Misioni

Misioni i Planit Social të Bashkisë Vau Dejes është të ofrojë shërbime dhe mbështetje për të përmirësuar cilësinë e jetës së qytetarëve, veçanërisht atyre në nevojë. Kjo përfshin ofrimin e ndihmës për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara, dhe familjet me të ardhura të ulëta, duke promovuar përfshirjen sociale dhe krijimin e një rrjeti mbështetës që siguron një jetë më të mirë dhe më të pavarur për të gjithë.

3.Parimet e Planit Social Vendor

Plani Social Vendor i Bashkisë Vau Dejes synon të përfshijë në mënyrë të barabartë të gjithë grupet dhe individët në nevojë, duke respektuar të drejtat e njeriut dhe duke trajtuar çështje sociale si varfëria, pabarazia dhe mungesa e aksesit në shërbimet e domosdoshme. Parimet dhe hapat kyç që përfshihen në këtë Plan janë:

Përfshirja sociale: Sigurimi i mundësive dhe qasjes së barabartë për të gjithë individët në shërbime dhe burime, duke përfshirë çdo komunitet dhe duke eliminuar përjashtimet.

Respektimi i të drejtave të njeriut: Promovimi i dinjitetit dhe respektimit të të drejtave themelore të individëve për të siguruar integritimin dhe përfshirjen e tyre të plotë në shoqëri.

Bashkëpunimi dhe partneriteti: Krijimi i aleancave me organizata jo-qeveritare, sektorin privat dhe aktorë të tjerë të shoqërisë për të arritur objektivat sociale të përbashkëta.

Trajtimi i varfërisë dhe pabarazisë: Ndërmarrja e veprimeve për të luftuar varfërinë dhe pabarazinë, duke ofruar mbështetje të drejtpërdrejtë për grupet më të prekura nga këto fenomene.

Zhvillimi i qëndrueshëm: Përparimi drejt një zhvillimi social të qëndrueshëm lokal, duke marrë parasysh mirëqenien afatgjatë të individëve dhe familjeve.

Konfidencialiteti dhe mbrojtja e të dhënave personale: Sigurimi i ruajtjes dhe mbrojtjes së të dhënave personale në përputhje me ligjin për mbrojtjen e të dhënave.

Qeverisja e mirë: Sigurimi i transparencës, pjesëmarrjes së qytetarëve dhe llogaridhënies në të gjitha proceset e vendimmarrjes.

Universaliteti dhe mosdiskriminimi: Garantimi i qasjes së barabartë për të gjithë dhe luftimi i çdo lloj diskriminimi, duke krijuar një ambient të drejtë dhe të barabartë për të gjithë.

Këto parime janë të rëndësishme për krijimin e një Plani Social që trajton nevojat dhe sfidat sociale të banorëve të Bashkisë Vau Dejes, duke garantuar përfshirje, drejtësi dhe zhvillim të qëndrueshëm të komunitetit.

II. ANALIZA E SITUATËS

1. Kuadri strategjik

Plani Social Vendor hartohet në përputhje me:

- Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë;
- Konventën për të Drejtat e Njeriut;
- Konventën për të Drejtat e Fëmijëve;
- Konventën e të Drejtave të Personave me Aftësi të Kufizuara;
- Kartën Sociale Evropiane (e rishikuar);
- Kartën Evropiane të Autonomisë Lokale;
- Standardet e Organizatës Botërore të Shëndetit (OBSh);
- Marrëveshjes së Stabilizim-Asociimit;
- CEDAW

Dokumentet strategjike:

- Strategjia e Mbrojtjes Sociale 2024-2030
- Dokumenti i Përfshirjes Sociale 2024-2028
- Plani Kombëtar i moshimit 2020-2024
- Plani Kombëtar LGBTI+ 2021-2027
- Plani Kombëtar për R&E 2021-2025
- Agjenda e Fëmijëve 2021-2026
- Plani Kombëtar i Veprimit PAK 2021-2025

Korniza e përgjithshme ligjore,¹ mbi bazën e të cilës organizohet dhe realizohet mbrojtja, kujdesi dhe integrimi social përbëhet nga:

- Ligji nr. 57/2019 “Për asistencën sociale në Republikën e Shqipërisë”;

¹VKM 613/2024-ndryshimi i VKM 111/2018 për ngritjen e FS në nivel vendor

- Ligji nr.121/2016, “Për shërbimet e kujdesit shoqëror në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 104/2014, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 7703, datë 11.5.1993, "Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr.10107/2009, “Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”;
- Ligji nr. 139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”;
- Ligji nr. 8137/1996 “Për ratifikimin e Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” (FZ 20-1996).


2. Nevojat, shërbimet e ofruara dhe boshllëqet

Vlerësimi i nevojave

Të dhënat demografike

Planifikimi social efektiv duhet të bazohet në një kuptim të qartë të tendencave demografike, të cilat ndikojnë drejtpërdrejt në zhvillimin ekonomik dhe mirëqenien sociale të komunitetit. Bashkia Vau Dejës ka një popullsi totale prej 50,131 banorësh, të shpërndarë në gjashtë njësi administrative: Vau Dejës, Bushat, Hajmel, Vig Mnele, Temal dhe Shllak. Pjesa më e madhe e popullsisë është përqendruar në Bushat (48% e totalit), ndërsa Shllaku dhe Vig Mnele kanë numrin më të ulët të banorëve, duke reflektuar një tendencë të shpërnguljes nga zonat më rurale drejt qendrave urbane.

Të dhënat e Censit 2023 tregojnë se popullsia e qarkut Shkodër ka rënë me 28.3% nga viti 2011 deri në 2023, një nga rëniet më të larta në vend, për shkak të migrimit të brendshëm dhe të jashtëm. Të rinjtë dhe familjet e reja largohen drejt qyteteve si Shkodra, Tirana dhe Durrësi, ose jashtë vendit, kryesisht në Angli, Itali dhe Gjermani. Plakja e popullsisë është një tjetër sfidë, pasi 19.7% e popullsisë janë mbi 65 vjeç, me një përqendrim më të lartë në zonat rurale si Temal dhe Shllak. Këto prirje ndikojnë drejtpërdrejt në strukturën e fuqisë punëtore, duke ngadalësuar zhvillimin ekonomik dhe duke krijuar presion mbi sistemet e shërbimeve sociale.



Grafiku më poshtë tregon shpërndarjen e popullsisë sipas grupmoshave, bazuar në tendencat kombëtare të Censit të Popullsisë 2023. Struktura demografike tregon një përqindje të konsiderueshme të popullsisë mbi 65 vjeç, duke theksuar fenomenin e plakjes dhe nevojën për politika sociale që mbështesin këtë grupmoshë.

Pa ndërhyrje të menjëhershme, rënia e popullsisë dhe plakja do të ndikojnë negativisht në bujqësinë dhe ekonominë vendore, duke çuar në tkurrjen e mëtejshme të komunitetit. Për të frenuar emigrimin dhe përmirësuar kushtet e jetesës, nevojiten investime në infrastrukturë, punësim dhe turizëm rural. Gjithashtu, një strategji më e mirë monitorimi dhe planifikimi është thelbësore për adresimin e nevojave të popullsisë dhe zhvillimin afatgjatë të bashkisë.


Në përfundim, sfidat e mëdha demografike kërkojnë masa të menjëhershme dhe të qëndrueshme, duke përfshirë zhvillimin e zonave të braktisura, fuqizimin e sektorit bujqësor dhe blegtoral, dhe krijimin e programeve sociale për të moshuarit, në mënyrë që të ruhet ekuilibri demografik dhe të sigurohet një zhvillim i qëndrueshëm për komunitetin.

Të dhënat nga statistikat e mirëqenies dhe shërbimeve sociale Ndihma Ekonomike për familjen në nevojë

Bashkia Vau Dejës ka gjithsej **1,035 familje përfituese të Ndhmës Ekonomike (NE)**, të shpërndara në gjashtë njësi administrative të cilat përbejnë 17.8% e popullsisë që jeton në bashki sipas Cens 2023. Këto të dhëna pasqyrojnë dinamika sociale dhe ekonomike të ndryshme midis zonave urbane dhe rurale, si dhe nevojat specifike të grupeve vulnerabël. Shumica e përfituesve i përkasin grupmoshës 19-65 vjeç, që përfaqëson pjesën aktive të popullsisë.

1. Shpërndarja e familjeve përfituese sipas Njësi Administrative

- **Vau Dejës** ka numrin më të madh të familjeve përfituese, me **286 familje (27.6%)**, duke reflektuar përqendrimin më të madh të varfërisë në këtë zonë urbane.
- Njësitë **Hajmel dhe Bushat** zënë përkatësisht **202 dhe 170 familje**, që pasqyrojnë gjithashtu sfida të mëdha ekonomike.
- Njësitë më rurale, si **Temal dhe Shllak**, kanë nga **133 familje secila**, ndërsa **Vig Mnele** ka numrin më të ulët të përfituesve me **111 familje (10.7%)**.




Grafiku tregon shpërndarjen e numrit të familjeve përfituese të NE sipas njësive, duke evidentuar përqendrimin më të madh në Vaun e Dejës.

2. Struktura e familjeve sipas numrit të anëtarëve


- **Familjet me 3-5 anëtarë** përbëjnë shumicën e përfituesve (64.20%), duke treguar se këto përfaqësojnë tipologjinë më të zakonshme të familjeve që kërkojnë ndihmë.
- **Familjet me mbi 6 anëtarë** përbëjnë vetëm 4.00%, duke theksuar nevojën për politika specifike për këtë kategori.
- **Familjet me 1-2 anëtarë** përbëjnë 22.15% të totalit, që përfshin individë të vetëm ose çifte pa fëmijë.

Gradiku pasqyron përqindjen e familjeve përfituese sipas numrit të anëtarëve, duke nënvizuar dominimin e familjeve me 3-5 anëtarë.



3. Struktura e përfituesve sipas grupmoshës

- Grupmosha 19-65 vjeç dominon me **2,023 përfitues (59.16%)**, duke reflektuar përfshirjen e pjesës aktive të popullsisë.
- Fëmijët (0-15 vjeç) përbëjnë **21.17%** të përfituesve, duke nënvizuar nevojën për programe që mbështesin rritjen dhe zhvillimin e tyre.
- Të moshuarit mbi 65 vjeç përbëjnë **11.97%**, duke kërkuar mbështetje të veçantë për shkak të pamundësisë për të punuar.



Ky grafik tregon numrin e individëve përfitues sipas grupmoshës, me fokus të veçantë te grupi 19-65 vjeç, që përfaqëson shumicën e përfituesve.

Ndikimet Sociale dhe Ekonomike

- ✓ **Dallimet mes zonave urbane dhe rurale:** Përqëndrimi i përfituesve në zona urbane si Vau Dejës thekson nevojën për politika që krijojnë mundësi ekonomike në zonat rurale.
- ✓ **Fëmijët dhe të moshuarit në nevojë:** Pjesëmarrja e lartë e këtyre grupeve në skemën e NE kërkon politika specifike për akses më të mirë në arsim dhe shëndetësi.
- ✓ **Të rriturit dhe sfida e punësimit:** Shumica e përfituesve janë në moshë pune, duke reflektuar mungesën e mundësive të qëndrueshme të punësimit dhe varësinë nga ndihma ekonomike.

Struktura e familjeve përfituese të NE në Bashkinë Vau Dejës tregon sfida të mëdha sociale dhe ekonomike që kërkojnë zgjidhje të qëndrueshme dhe ndërhyrje të targetuara. Zhvillimi i programeve për fuqizimin ekonomik dhe përmirësimin e kushteve të jetesës do të ndihmojë në reduktimin e varfërisë dhe përmirësimin e mirëqenies për komunitetin.


Punëkërkuesit e papunë

Analiza e Punësimit dhe Formimit Profesional në Bashkinë Vau Dejës

Sipas të dhënave nga Drejtoria Rajonale e Punësimit Shkodër, më 15 Gusht 2024, në Bashkinë Vau Dejës rezultojnë 282 punëkërkues të papunë të regjistruar (2.3% e popullsisë 16-67 vjeç sipas Cens 2023). Ky numër përfaqëson individë në situata të ndryshme sociale dhe ekonomike, duke përfshirë ata që kanë humbur punën, të rinjtë që nuk kanë arritur të futen në tregun e punës dhe persona me aftësi të kufizuara ose me vështirësi në punësim. Struktura e papunësisë reflekton një kategori të larmishme në aspektin e moshës, nivelit arsimor dhe sfidave specifike, duke theksuar nevojën për politika të personalizuar për fuqizimin ekonomik të këtyre individëve.

1. Papunësia sipas grupmoshave:


- ✓ **Grupi mbi 40 vjeç** ka numrin më të lartë të të papunëve (**178 persona**), duke reflektuar vështirësi në riintegrimin në tregun e punës.
- ✓ Grupmoshat **16-19 vjeç dhe 20-24 vjeç** kanë një numër më të ulët të të papunëve (përkatesisht **10 dhe 31 persona**), megjithatë, kjo kategori përbën një segment me nevojë për përfshirje në formim profesional.



Papunësia sipas grupmoshave – Tregon që grupmosha mbi 40 vjeç përballet me vështirësitë më të mëdha në punësim

2. Papunësia sipas nivelit arsimor:

- ✓ **176 persona (62.4%)** kanë vetëm arsim 9-vjeçar, tregues që dëshmon nevojën për trajnime profesionale për këtë kategori.
- ✓ Vetëm **21 persona me arsim universitar** janë të papunë, çka sugjeron që papunësia prek më së shumti ata me arsim të ulët ose të mesëm.
- ✓ **21 të papunë kanë mbaruar shkollën e mesme profesionale**, duke treguar mungesën e mundësive të punësimit edhe për këtë kategori.



Papunësia sipas nivelit arsimor – Evidencon faktin që shumica e të papunëve kanë vetëm arsim 9-vjeçar, duke theksuar nevojën për trajnime profesionale

3. Punëkërkues të Papunë nga familjet përfituese të Ndihmës Ekonomike (NE)

Nga 282 **punëkërkues të papunë**, 123 prej tyre janë anëtarë të familjeve përfituese të NE (**60 janë femra dhe 63 meshkuj**), me përqendrimin më të lartë në:

- ✓ **Vau Dejës (110 persona)**, duke pasuar Bushatin (8 persona) dhe njësitë e tjera me një numër minimal përfituesish.
- ✓ Të dhënat sugjerojnë që papunësia prek kryesisht individët në nevojë në qendrat më të populluara të bashkisë.

4. Punësimi dhe Formimi Profesional

Bashkia Vau Dejës përballlet me sfida të shumta në tregun e punës, ku grupet më të prekura janë gratë dhe të rinjtë. Gratë kanë mundësi të kufizuara punësimi për shkak të përqendrimit në sektorë me të ardhura të ulëta, mungesës së mbështetjes për sipërmarrësi dhe përgjegjësi familjare që kufizojnë përfshirjen e tyre në tregun e punës. Të rinjtë, nga ana tjetër, hasin vështirësi në gjetjen e një vendi pune për shkak të mungesës së përvojës dhe mungesës së trajnimeve të përshtatura për kërkesat e tregut.

5-Sfidat Kryesore

- **Mundësitë e kufizuara për punësim të grave dhe vajzave:** Gratë përballen me pengesa të shumta në tregun e punës, përfshirë mungesën e politikave mbështetëse për fuqizimin ekonomik të tyre dhe sektorët me paga të ulëta ku ato janë të përqendruara.
- **Papunësia e lartë tek të rinjtë:** Shumë të rinj e kanë të vështirë të futen në tregun e punës për shkak të mungesës së përvojës dhe trajtimeve të përshtatura për sektorët me kërkesë të lartë.
- **Mungesa e arsimit profesional dhe aftësimit për punë:** Numri i lartë i të papunëve me vetëm shkollë 9-vjeçare tregon nevojën për investime në programe trajnimi që i përgjigjen kërkesave të tregut.
- **Papunësia në moshat mbi 40 vjeç:** Kjo kategori përballlet me vështirësi në riintegrimin në tregun e punës, për shkak të mungesës së aftësive të reja dhe kërkesave të tregut.
- **Mungesa e të dhënave të detajuara për formimin profesional:** Nuk ka të dhëna specifike për pjesëmarrjen në kurse profesionale në nivel bashkie, duke e bërë të vështirë matjen e ndikimit të tyre.

Bashkia Vau Dejës përballlet me një sfidë të rëndësishme në lidhje me papunësinë dhe formimin profesional, veçanërisht për gratë, të rinjtë dhe individët me arsim të ulët. Investimet në aftësimin profesional dhe integrimin në tregun e punës janë thelbësore për të reduktuar varësinë nga ndihma ekonomike dhe për të rritur punësimin në bashki.

Individë me aftësi të kufizuar

Sipas censusit, popullsia e Bashkisë Vau-Dejës është **19,261 banorë**, nga të cilët **7.7%** (1,484 persona) përballen me aftësi të kufizuar (PAK) dhe përfitojnë pagesë për shkak të statusit të tyre. Numri i personave që përfitojnë pagesë ka rënë nga 1,301 në 2022 në 1,238 në 2024. Kategoritë kryesore të PAK janë:



Para dhe tetraplegjikë zënë 3.37% e PAK. Kjo përqindje është relativisht e ulët, por duke qenë një kategori me nevoja të mëdha, kërkon mbështetje të specializuar.

Të verbër zënë 7.81% e totalit të PAK. Numri i tyre është domethënës dhe mund të tregojë mungesë të kujdesit oftalmologjik ose ekspozim të lartë ndaj faktorëve që ndikojnë në shikim.

Invalidë zënë 30.05% e totalit të PAK. Ky është grupi më i madh dhe përfshin ata që kanë humbur aftësinë për punë për shkak të sëmundjeve kronike, aksidenteve ose


faktorëve të tjerë social-ekonomikë.

PAK të tjerë zënë 42.17% e totalit. Ky grup përfshin individë me aftësi të kufizuara të ndryshme, përfshirë çrregullime mendore dhe zhvillimore.

Shifrat tregojnë se invalidët dhe personat me aftësi të kufizuara të tjera përbëjnë **72.2%** të totalit të PAK, duke e bërë të domosdoshme një analizë të thelluar të shkaqeve të kësaj gjendjeje dhe përmirësimin e shërbimeve të rehabilitimit.

28.8% e PAK jetojnë në qendrën e bashkisë (Vau Dejës) dhe **71.2%** jetojnë në njësitë administrative.

Kjo shpërndarje tregon se shumica e PAK jetojnë në zonat rurale, ku qasja në shërbime shëndetësore dhe sociale mund të jetë më e kufizuar. Ky fakt kërkon një qasje më të decentralizuar në ofrimin e shërbimeve për këtë kategori, duke sjellë kujdesin shëndetësor dhe shërbimet e ndihmës më pranë komuniteteve të largëta. **56.8%** e PAK jetojnë në Njësinë Administrative Bushat, **28.8%** e PAK jetojnë në Vaun e Dejës dhe pjesa tjetër në **njësitë e tjera** (Hajmel, Vig-Mnelë, Temal, Shllak). Përqendrimi i madh i PAK në Bushat tregon nevojën për një analizë më të thellë mbi faktorët që ndikojnë në këtë nivel të lartë dhe për ndërhyrje të posaçme në këtë zonë.



1-Shërbimi i Ndihmës Personal

Ndihmësi personal është thelbësor për mbështetjen e jetës së përditshme të PAK. Megjithatë, analiza tregon se:

- **100%** e personave para dhe tetraplegjikë marrin ndihmës personal, çka është një tregues pozitiv.
- Vetëm **35.34%** e të verbërve kanë ndihmës personal, duke sugjeruar një nevojë të madhe për zgjerimin e mbështetjes për këtë kategori.

- **0%** e invalidëve përfitojnë ndihmës personal, duke ngritur shqetësime për cilësinë e jetës dhe mbështetjen për këtë grup që përbën një të tretën e totalit të PAK.
- **20.29%** e PAK të tjerë përfitojnë ndihmës personal, duke treguar një mbulim të pamjaftueshëm për këtë kategori.

Kjo situatë nënvizon **nevojën urgjente për zgjerimin e shërbimeve mbështetëse**, si një mekanizëm thelbësor për rritjen e autonomisë dhe cilësisë së jetës së personave me aftësi të kufizuara. Në mungesë të një skeme të zgjeruar të ndihmës personal, ky grup mbetet i izoluar, i varur nga familja ose, në rastet më të vështira, i privuar nga një kujdes i strukturuar. Për këtë arsye, është e domosdoshme zhvillimi i një strategjie të re për sigurimin e shërbimeve të ngjashme me ndihmës personal për të gjitha kategoritë e PAK që kanë nevojë, duke vendosur prioritet për ata që aktualisht janë tërësisht të papërfshirë në këtë shërbim.

2-Aksesi në Arsim

Pjesëmarrja e PAK në arsim është shumë e ulët:

- Vetëm **1.62%** e PAK ndjekin arsimin 9-vjeçar.
- Vetëm **0.88%** ndjekin arsimin e mesëm.
- Vetëm **0.13%** ndjekin arsimin e lartë.

Këto përqindje tregojnë një shkallë të ulët të përfshirjes në arsim, duke sinjalizuar barriera të mëdha si: i)Mungesa e infrastrukturës së përshtatshme në shkollë; ii)Mungesa e programeve të personalizuara për PAK; iii)Kufizime në transport dhe akses në institucionet arsimore. Kjo situatë ka ndikim afatgjatë në mundësitë e punësimit dhe përfshirjes sociale të PAK, duke i lënë ata në varësi më të madhe nga ndihma shtetërore.

3-Aksesi në shërbimet shoqërore për PAK

Në Bashkinë Vau Dejës, ofrimi i shërbimeve për personat me aftësi të kufizuara mbetet i kufizuar dhe i fragmentuar.

Aktualisht, shërbimi i lëvizshëm financiar nga Fondi Social (MSHMS) dhe Bashkia Vau Dejës mbulon vetëm 25 persona me aftësi të kufizuara në të gjithë territorin e bashkisë.Ndërkohë, qendra rezidenciale e Vëllezërve të Nënë Terezës strehon 36 persona me aftësi të kufizuara, të gjithë meshkuj të moshës 26-65 vjeç. Ky shërbim operon në nivel kombëtar, por mungojnë të dhënat mbi numrin e banorëve të Bashkisë Vau Dejës që përfitojnë prej tij.

Mungesa e shërbimeve të qëndrueshme ka krijuar një boshllëk të theksuar në mbështetjen për këtë kategori. Shërbimet alternative janë të mbyllura ose funksionojnë në mënyrë sporadike, duke lënë shumë persona me aftësi të kufizuara pa mbështetje të strukturuar dhe të vazhdueshme. Kjo situatë kërkon ndërhyrje të menjëhershme për zgjerimin dhe përmirësimin e shërbimeve në nivel komunitar.

4-Aksesi në punësim

Punësimi i personave me aftësi të kufizuara (PAK) mbetet një sfidë e rëndësishme në Bashkinë Vau Dejës, për shkak të numrit të lartë të tyre në raport me mundësitë e kufizuara për përfshirje në tregun e punës.

Sipas të dhënave të disponueshme nga Drejtoria Vendore e Punësimit Shkodër dhe Bashkisë Vau Dejës, në këtë bashki janë të regjistruar gjithsej 1338 persona me aftësi të kufizuara të rritur, por vetëm 19 PAK figurojnë të regjistruar si të papunë punëkërkues në zyrat e punës, që përbën 1.4% të totalit të PAK. Ky numër përfaqëson 6.7% të totalit të 282 punëkërkuesve të papunë të regjistruar në bashki, duke treguar qartë vështirësitë e mëdha me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara për t'u integruar në tregun e punës.

Personat me aftësi të kufizuara përballen me mungesën e programeve të dedikuara për përgatitjen dhe trajnimin profesional, duke i penguar të zhvillojnë aftësitë e nevojshme për tregun e punës. Gjithashtu, barrierat infrastrukturore kufizojnë aksesin e tyre në vende pune të përshtatshme, ndërsa qëndrimet diskriminuese dhe mungesa e mbështetjes sociale e bëjnë edhe më të vështirë përfshirjen e tyre në tregun e punës. Për të përmirësuar këtë situatë, është e nevojshme hartimi i politikave mbështetëse që nxisin përfshirjen e tyre në tregun e punës, stimulimi i bizneseve për të krijuar vende pune të përshtatshme dhe forcimi i bashkëpunimit me institucionet përgjegjëse për punësimin.

Sfidat kryesore me të cilat përballen personat me aftësi të kufizuara janë:

- Mungesa e shërbimeve të decentralizuara për PAK në zonat rurale.
- Mbulimi i pamjaftueshëm me ndihmës personal, veçanërisht për invalidët dhe të verbër.
- Përfaqësimi i ulët në arsim, me mundësi të kufizuara edukimi dhe integrimi.
- Mungesa e shërbimeve sociale, me vetëm një qendër funksionale dhe pa opsione alternative.
- Mungesa e politikave dhe buxhetit të dedikuar, duke e lënë këtë kategori të pambështetur institucionalisht.

Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe/ose përkujdesje


1-Fëmijë në rrisht

Sipas Cens 2023, Bashkia Vau-Dejës numëron 3,017 fëmijë të grupmoshës 0-13 vjeç. Të dhënat e INSTAT tregojnë se numri i lindjeve në këtë bashki ka pësuar një ulje të lehtë krahasuar me vitet e mëparshme, duke reflektuar tendencën e përgjithshme demografike të vendit. Ndërkohë, një pjesë e konsiderueshme e këtyre fëmijëve ndodhen në rrezik social për shkak të kushteve të vështira ekonomike dhe mungesës së shërbimeve mbështetëse konkretisht:

- **Fëmijë në konflikt me ligjin** – Vetëm **1 rast i identifikuar**, por përvoja nga bashki të tjera tregon se mungesa e mbështetjes së hershme mund të çojë në rritjen e këtij fenomeni. Nevojitet krijimi i programeve të ndërhyrjes së shpejtë dhe rehabilitimit për fëmijët me sjellje të rrezikshme.
- **Fëmijë viktimë të dhunës** – Janë regjistruar **5 raste (2 meshkuj dhe 3 femra)**, por përvoja tregon se numri real mund të jetë më i lartë për shkak të mungesës së raportimit. Nevojiten mekanizma të fuqishëm për identifikimin dhe mbrojtjen e fëmijëve.
- Nuk ka raste të evidentuar **për fëmijë të shfrytëzuar për punë**, por në zonat rurale, fëmijët shpesh përfshihen në punë bujqësore dhe tregtare, duke ndikuar në arsimimin e tyre. Nevojitet monitorim më i mirë dhe ndërgjegjësim për të ndaluar shfrytëzimin e fshehur të fëmijëve.

Fëmijët që jetojnë në familjeve përfituese të ndihmës ekonomike dhe ata me aftësi të kufizuara përballen me sfida të mëdha në arsim, mirëqenie dhe përfshirje sociale. Mungesa e mbështetjes i ekspozon ndaj rrezikut të braktisjes shkollore, kequshqyerjes dhe izolimit,

duke kërkuar masa të koordinuara për të siguruar akses të barabartë në shërbime dhe mundësi zhvillimi. Në Bashkinë Vau Dejës evidentohen:



- ✓ **724 fëmijë (0-15 vjeç) të Bashkisë jetojnë në familje me NE**, duke treguar nevojën për mbështetje sociale. Shumë prej këtyre fëmijëve rrezikojnë kequshqyerjen dhe braktisjen shkollore.
- ✓ **263 fëmijë mbi 15 vjeç** ndodhen në këtë kategori, me një tendencë të lartë për t'u larguar nga shkolla dhe për t'u futur herët në tregun e punës në mungesë të mbështetjes edukative dhe profesionale.

Grafiku tregon numrin e fëmijëve që jetojnë në familje përfituese të ndihmës ekonomike (NE) në Bashkinë Vau Dejës. Këto të dhëna tregojnë nevojën për politika të qëndrueshme mbështetëse për të parandaluar braktisjen shkollore dhe për të krijuar mundësi zhvillimi për fëmijët nga familjet në nevojë.

146 fëmijë me AK janë evidentuar në territorin e bashkisë Vau Dejës të cilët përfitojnë një pagesë mujore në cash si mbështetje financiare për shkak të aftësisë së kufizuar. Kjo pagesë, së bashku me ndihmësin personal për një pjesë të këtyre fëmijëve, përbën **të vetmen formë mbështetjeje** nga institucionet publike. Megjithatë ndihma financiare është e rëndësishme, mungesa e shërbimeve të specializuara për rehabilitim, edukim dhe përfshirje sociale krijon sfida të mëdha për këta fëmijë dhe familjet e tyre. Kjo situatë tregon nevojën për politika më gjithëpërfshirëse, që të sigurojnë jo vetëm mbështetje ekonomike, por edhe akses në shërbime cilësore për zhvillimin dhe integrimin e tyre në shoqëri.

2. Akses në Arsim

Bazuar në të dhënat e sistemit arsimor parauniversitar në Bashkinë Vau-Dejës, rezulton se fëmijët kanë akses në **katër nivele arsimimi**: arsimi parashkollor (kopshte), shkollën 9-vjeçare, shkollat e mesme dhe shkollën e mesme profesionale. Megjithatë, analiza tregon sfida të ndryshme në përfshirjen e fëmijëve, veçanërisht atyre nga familje në nevojë dhe fëmijëve me aftësi të kufizuara, konkretisht:

2.1 Akses në arsimin parashkollor

Në Bashkinë Vau Dejës mungon shërbimi i çerdheve për fëmijët 0-3 vjeç.

20 kopshte publike operojnë në 6 njësitë administrative të Bashkisë Vau Dejës me 508 fëmijë. Mungojnë të dhënat mbi përfshirjen e fëmijëve nga familje me NE ose me AK, duke ngritur dyshime mbi barazinë e aksesit në arsimin parashkollor.

2.2 Akses në arsimin 9-Vjeçar

Në bashki funksionojnë **10 shkolla 9-vjeçare** me **1,742 nxënës**. **800 janë vajza** dhe **942 djem**, duke treguar një përfaqësim të balancuar gjinor. **410 nxënës** vijnë nga familje në nevojë, një përqindje e konsiderueshme që tregon se sfidat ekonomike ndikojnë në përfshirjen në arsim. Disa prej këtyre nxënësve vijnë nga zona të largëta dhe kanë vështirësi për transportin shkollore (2 njësi administrative kanë 1 shkollë të përbashkët). **Vetëm 19 fëmijë me aftësi të kufizuara**

ndjekin arsimin 9-vjeçar, çka tregon mungesë aksesibiliteti dhe mundësi të kufizuara për këtë kategori.

2.3 Aksesimi në Arsimin e Mesëm

Në Bashkinë Vau Dejës funksionojnë **5 shkolla të mesme**, ku janë të regjistruar gjithsej **448 nxënës**, prej të cilëve **205 janë vajza dhe 243 djem**. Ky numër është ndjeshëm më i ulët krahasuar me arsimin bazë, duke reflektuar sfidat e regjistrimit dhe vijimit të shkollimit në këtë nivel.

Fëmijët nga Njësitë Administrative Vig-Mnelë, Temal dhe Shllak detyrohen të ndjekin arsimin e mesëm në shkollat e njësive të tjera, pasi në këto zona nuk ka shkolla të mesme për shkak të numrit të ulët të nxënësve. Kjo pengesë e bën më të vështirë aksesin në arsim për fëmijët e këtyre zonave.

Për më tepër, vetëm 24 nxënës nga familje në nevojë vijojnë arsimin e mesëm, duke sugjeruar një lidhje të fortë mes kushteve ekonomike dhe braktisjes shkollore. Gjithashtu, vetëm 6 fëmijë me aftësi të kufizuara ndjekin shkollën e mesme, duke treguar sfida të mëdha në aksesin e kësaj kategorie ndaj arsimit të lartë.

2.4 Arsimi Profesional

Në bashki funksionon vetëm **1 shkollë e mesme profesionale**, me **103 nxënës**. **40 janë vajza dhe 63 djem**, duke treguar përfshirje më të ulët të vajzave në këtë nivel arsimor. **Nuk ka asnjë nxënës nga familje në nevojë** që ndjek arsimin profesional, çka sugjeron mungesën e politikave mbështetëse për këtë grup. **Asnjë fëmijë me aftësi të kufizuara nuk ndjek arsimin profesional**, çka tregon mungesën e infrastrukturës dhe programeve të përshtatura për këtë kategori



Grafiku tregon shpërndarjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara (AK) sipas niveleve arsimore në Bashkinë Vau Dejës. Ajo që bie më shumë në sy është mungesa totale e fëmijëve me AK në arsimin profesional, çka tregon vështirësi të mëdha në qasjen ndaj arsimit të specializuar dhe mungesën e infrastrukturës mbështetëse për këtë kategori. Ky trend ngre shqetësime për të ardhmen e këtyre fëmijëve, pasi mungesa e arsimit i ekspozon ata ndaj përjashtimit social dhe vështirësive për punësim.

3. Aksesimi në shërbime shoqërore

Organizata për Djem dhe Burra ofron një **shërbim ditor mbështetës për 10 fëmijë nga familjet përfituese të ndihmës ekonomike (NE)**, duke u siguruar atyre një mjedis të sigurt dhe mbështetje për zhvillimin e tyre social dhe edukativ. Ky është shërbimi shoqëror i vetëm në nivel bashkie që ndihmon në **lehtësimin e barrës socio-ekonomike të familjeve në nevojë**, duke ofruar kujdes ditor dhe aktivitete që përmirësojnë mirëqenien dhe përfshirjen e fëmijëve në komunitet.


Sfidat Kryesore

- **Mungesa e shërbimeve të decentralizuara** – Fëmijët me AK dhe ata nga familje me NE kanë vështirësi të mëdha për të aksesuar shërbime sociale dhe edukative, veçanërisht në njësitë administrative rurale.
- **Braktisja shkollore dhe përfshirja e ulët në arsim** – Shumë fëmijë nga familjet me NE nuk e ndjekin arsimin e mesëm për shkak të pamundësisë financiare dhe mungesës së mbështetjes institucionale.
- **Mungesa e shërbimeve alternative të kujdesit** – Nuk ka struktura mbështetëse për fëmijët pa kujdes prindëror, dhe nuk ka programe për strehim apo kujdestari të përkohshme.
- **Mungesa e programeve të specializuara për fëmijët me AK** – Shumica e shkollave nuk janë të pajisura për të akomoduar fëmijët me nevoja të veçanta, dhe nuk ka mbështetje të mjaftueshme për mësuesit.

Viktima të dhunës në familje

Dhuna në familje dhe dhuna me bazë gjinore mbeten një sfidë serioze sociale në Bashkinë Vau Dejës, duke ndikuar si te viktimat, ashtu edhe në stabilitetin dhe mirëqenien e komunitetit. Analiza vlerëson situatën aktuale të dhunës, bazuar në të dhënat e vitit 2024, dhe ofron një krahasim me vitet e mëparshme, duke shqyrtuar faktorët social-ekonomikë që ndikojnë në raportimin dhe trajtimin e rasteve.

Gjatë vitit 2024 janë regjistruar **8 raste të dhunës**, krahasuar me **6 raste në 2023** dhe **15 raste**




në 2022. Luhatja në shifra lidhet me faktorë të ndryshëm, përfshirë rritjen e ndërgjegjësimit përmes fushatave sensibilizuese dhe përmirësimin e mekanizmave të referimit. Megjithatë, frika nga stigmatizimi dhe mungesa e alternativave ekonomike vazhdojnë të pengojnë raportimin e dhunës, veçanërisht në zonat rurale.

Të dhënat e vitit 2024 tregojnë se gratë përbëjnë pjesën më të madhe të viktimave, me **10 raste**, duke konfirmuar prevalencën e dhunës me bazë gjinore. Krahas tyre, është regjistruar një rast dhune ndaj një fëmije dhe një tjetër ndaj një të moshuari, ndërsa nuk ka raste të raportuara të dhunës ndaj burrave. Kjo mund të nënkuptojë jo mungesën e dhunës, por mungesën e denoncimeve për shkak të frikës dhe stigmatizimit.

Profili i Viktimave të Dhunës në Bashkinë Vau Dejës (2024)




Numri më i lartë i rasteve është raportuar në njësinë administrative **Bushat (4 raste)**, ndjekur



nga **Hajmel (3 raste)** dhe **Vau Dejës (1 rast)**, ndërsa në **Vig Mnele, Temal dhe Shllak** nuk është raportuar asnjë rast. Mungesa e raportimeve në disa zona mund të lidhet me vështirësitë në aksesimin e shërbimeve dhe besimin e ulët në institucionet përgjegjëse. Kjo situatë thekson nevojën për përmirësimin e mekanizmave të raportimit dhe ndërgjegjësimin në komunitet.

Faktorët social-ekonomikë luajnë një rol kyç në ekspozimin dhe përjetimin e dhunës, duke ndikuar drejtpërdrejt në aftësinë e viktimave për ta denoncuar dhe për t'u larguar nga situatat abuzive. **Varfëria dhe papunësia** janë ndër sfidat kryesore, pasi shumë viktimë, veçanërisht gratë, varen ekonomikisht nga abuzuesit e tyre, duke e bërë të vështirë largimin dhe sigurimin e një jetese të pavarur. Për më tepër, **izolimi social dhe stigma** përforcojnë heshtjen rreth dhunës, veçanërisht në zonat rurale, ku frika nga përjashtimi shoqëror dhe pasojat e mundshme sociale shpesh i pengojnë viktimat të raportojnë rastet.



Një tjetër sfidë madhore është **mungesa e një strehëze të sigurt**, e cila do të mundësonte mbrojtje të menjëhershme për viktimat që kërkojnë të largohen nga mjediset e dhunshme. Në mungesë të një alternative të tillë, shumë viktimë detyrohen të qëndrojnë në situata të pasigurta, duke e përkeqësuar më tej rrethin e dhunës dhe varësinë e tyre nga abuzuesi.

Mekanizmi i referimit funksionon përmes një punonjësi të dedikuar në bashki, i cili koordinon rastet me Policinë e Shtetit dhe institucionet e tjera sociale. Megjithatë, ky sistem ka nevojë për përmirësime, veçanërisht në sigurimin e ndihmës ligjore falas për viktimat, ku bashkëpunimi me OJF-të e Bashkisë Shkodër do të ishte një hap pozitiv. Gjithashtu, terreni i thyer dhe distancat e mëdha midis njësive administrative vështirësojnë aksesin në shërbime mbështetëse dhe ndihmë juridike.

Sfidat Kryesore


1. Mungesa e raportimit në disa zona rurale për shkak të stigmatizimit dhe frikës nga ndëshkimi.
2. Mungesa e një strehëze emergjente, e cila kufizon opsionet e viktimave për largim nga situatat e rrezikshme.
3. Fondet e pamjaftueshme për shërbime të specializuara dhe mbështetje psiko-sociale.
4. Terreni i vështirë dhe distancat e largëta, të cilat kufizojnë aksesin në ndihmën ligjore dhe shërbimet mbështetëse.
5. Nevoja për forcimin e bashkëpunimit me OJF-të për ndihmë ligjore falas dhe mbështetje të vazhdueshme.
6. Varfëria dhe pavarësia ekonomike e kufizuar e grave viktimë të dhunës, duke i detyruar të qëndrojnë në mjedise abuzive.

Individë/familje në nevojë për strehim social

Strehimi është një nga sfidat kryesore sociale në Bashkinë Vau Dejës, duke ndikuar drejtpërdrejt në cilësinë e jetës së grupeve të cënueshme si familjet në nevojë, personat me aftësi të kufizuara, jetimët, gratë kryefamiljare dhe viktimat e dhunës. Pavarësisht ekzistencës së disa instrumenteve mbështetëse si bonusi i qirasë dhe kredia e butë, të dhënat e viteve të fundit tregojnë një numër të kufizuar përfituesish, duke sinjalizuar sfida serioze në aksesin dhe efektivitetin e këtyre skemave.

1. Bonusi i Qirasë

Në periudhën e tre viteve të fundit, numri i aplikimeve për bonusin e qirasë ka pësuar një rënie të ndjeshme. Në vitin 2022, janë regjistruar 16 aplikime për këtë skemë, por ky numër ka rënë



dukshëm në vitin 2023, me vetëm 4 aplikime. Edhe pse në vitin 2024 ka pasur një rritje të vogël, me 6 aplikime, ky numër mbetet ende shumë i ulët. Po ashtu, përfitimi nga kjo skemë është tejet i kufizuar. Vetëm 2 individë përfituan bonusin e qirasë në 2022, ndërsa në 2023 dhe 2024 numri i përfituesve ka mbetur në nivele shumë të ulëta, duke arritur në 1 dhe 3 përfitues, përkatësisht. Kjo tregon se, përveç uljes së numrit të aplikimeve, përfitimi nga bonusi i qirasë ka mbetur jashtë arritshmërisë për shumicën e aplikantëve.

Të dhënat mbi karakteristikat e përfituesve të bonusit të qirasë në Bashkinë Vau Dejës tregojnë se shumica e tyre vijnë nga skema e ndihmës ekonomike, ndërsa grupet e tjera të cënueshme

	Nga skema e NE	PAK	Jetim	Gra k/familjare	Viktima të dhunës/ Urdhër mbrotje	Etni rom/egjiptian	Të tjerë
Viti 2022							
i) Bashkia,	2	0	0	0	0	0	0
ii) Njësitë,	0	0	0	0	0	0	0
Total i+ ii	2	0	0	0	0	0	0
Viti 2023							
i) Bashkia,	0	0	0	0	0	0	0
ii) Njësitë,	1	0	0	0	0	0	0
Total i+ ii	1	0	0	0	0	0	0
Viti 2024							
i) Bashkia,	1	0	0	1	0	0	0
ii) Njësitë,	0	0	0	0	0	0	0
Total i+ ii	1	0	0	1	0	0	0

mbeten pothuajse të papërfaqësuar.

Në vitin 2022, të vetmit përfitues ishin dy familje të përfshira në skemën e ndihmës ekonomike, ndërsa kategoritë si personat me aftësi të kufizuara, jetimët, gratë kryefamiljare dhe viktimat e dhunës nuk patën asnjë mbështetje. Ky trend vijoi edhe në vitin 2023, me vetëm një përfitues nga

ndihma ekonomike dhe asnjë nga kategoritë e tjera. Vetëm në vitin 2024, një grua kryefamiljare u përfshi në skemë, por sërish komunitetet rom dhe egjiptian mbeten plotësisht të përjashtuara nga kjo mbështetje. Këto shifra ngrenë shqetësime për mungesën e aksesit të barabartë në programet e strehimit dhe tregojnë nevojën për politika më të synuara, që të sigurojnë mbështetje për grupet më të cënueshme të shoqërisë

2. Kredia e Butë

Të dhënat mbi aplikimet dhe përfituesit e kredisë së butë në Bashkinë Vau Dejës tregojnë një situatë alarmante, ku asnjë aplikant nuk ka përfituar nga kjo skemë gjatë tre viteve të fundit. Në vitin 2022, u regjistruan pesë aplikime, por asnjëra nuk rezultoi e suksesshme, ndërsa në vitin 2023 numri i aplikimeve u ul në vetëm dy, pa asnjë përfitues. Situata u përkeqësua më tej në vitin 2024, kur nuk u regjistrua asnjë aplikim, duke sinjalizuar një mungesë të qartë interesi ose akses të kufizuar në këtë skemë mbështetëse. Këto të dhëna sugjerojnë nevojën për një analizë të mëtejshme mbi arsyet e mungesës së aplikimeve dhe përfituesve, si dhe rishikimin e kushteve dhe procedurave të aplikimit për të lehtësuar aksesin në financim për familjet në nevojë.

	Aplikime per kredi te bute	Perfitues te kredise se bute
Viti 2022		
i) Bashkia,	4	0
ii) Njësitë ,	1	0
Total i+ ii	5	0
Viti 2023		
i) Bashkia,	2	0
ii) Njësitë ,	0	0
Total i+ ii	2	0
Viti 2024		
i) Bashkia,	0	0
ii) Njësitë ,	0	0
Total i+ ii	0	0

3. Ndikimi i mungesës së strehimit

Mungesa e strehimit ndikon negativisht në cilësinë e jetës së familjeve në nevojë, duke sjellë pasiguri ekonomike dhe përjashtim social. Gratë kryefamiljare dhe viktimat e dhunës mund të mbeten të varura ekonomikisht nga dhunuesit, ndërsa komunitetet rom dhe egjiptian hasin barriera të shumta në përfitimin e shërbimeve sociale. Personat me aftësi të kufizuara dhe jetimët përballen me izolim të theksuar, duke kufizuar mundësitë e tyre për integrim. Përmirësimi i aksesit dhe mbështetjes për këto kategori do të ndikonte pozitivisht në integrimin e tyre social dhe sigurimin e kushteve më të mira të jetesës

Sfidat kryesore në strehim

Nga të dhënat e analizuara, evidentohen disa problematika të mëdha që prekin situatën e strehimit në Bashkinë Vau Dejës:

1. **Përfitimi i ulët nga skemat ekzistuese** – Shumë pak aplikantë arrijnë të përfitojnë, veçanërisht nga bonusi i qirasë dhe kredia e butë, duke treguar nevojën për një rishikim të kriterëve dhe proceseve përzgjedhëse.
2. **Mungesa e përfshirjes së grupeve të cënueshme** – Gratë kryefamiljare, viktimat e dhunës, personat me aftësi të kufizuara dhe komunitetet rom dhe egjiptian kanë akses të kufizuar ose zero në këto skema.
3. **Rënia e numrit të aplikimeve** – Rënia drastike e aplikimeve për strehim social mund të sinjalizojë mungesë informacioni, burokraci të vështirë ose kushte të pamundura për t'u plotësuar nga familjet në nevojë.
4. **Mungesa e programeve alternative të strehimit** – Përveç bonusit të qirasë dhe kredisë së butë, nuk ka skema të tjera mbështetëse, si strehimi social apo programe të tjera për banim të përballeshëm.

Të moshuar në nevojë për shërbime përkujdesi

Popullsia e moshuar përfaqëson një pjesë të konsiderueshme të banorëve të Bashkisë Vau Dejës, duke ndikuar drejtpërdrejt në politikat dhe masat sociale që duhet të adresohen. Me rritjen e fenomenit të plakjes së popullsisë, sfidat lidhur me mbështetjen dhe shërbimet sociale për këtë grupmoshë po bëhen gjithnjë e më të ndjeshme.


Sipas **Cens 2023**, numri i personave të moshuar në Bashkinë Vau Dejës është **4,237**, që përfaqësojnë **22% të popullsisë** së bashkisë. Këto të dhëna tregojnë një nivel të lartë plakjeje të popullsisë, duke nxjerrë në pah nevojën për shërbime të specializuara sociale për këtë kategori.

Bashkia Vau Dejes nuk ka nje data baze me të dhënat për personat e moshuar në nevojë. Bashkia ka identifikuar vetëm dy kategori kryesore:

- *Numri i të moshuarve që jetojnë vetëm dhe përfitojnë nga ndihma ekonomike (NE)*
- *Numri i të moshuarve me aftësi të kufizuara (AK)*

Në total, **163 të moshuar jetojnë vetëm dhe përfitojnë ndihmë ekonomike**, ndërsa **266 të moshuar klasifikohen si persona me aftësi të kufizuara**.


Në Bashkinë Vau Dejës, njësia administrative me numrin më të lartë të të moshuarve që jetojnë vetëm dhe përfitojnë ndihmë ekonomike është **Vau Dejës**, ku regjistrohen **140 persona**, nga



të cilët **86 janë gra dhe 54 burra**. Ky numër përbën **85% të totalit** të përfituesve në bashki, duke treguar një përqendrim të lartë të të moshuarve në nevojë për mbështetje sociale në këtë zonë. Nga ana tjetër, disa njësi të tjera paraqesin një numër minimal përfituesish. Njësia Administrative **Bushat** numëron vetëm **3 persona**, ndërsa në Njësinë Administrative **Hajmel** ky numër arrin në **7 përfitues**. Ndërkohë, në Njësinë

Administrative **Vig Mnelë** nuk ka asnjë të moshuar të regjistruar si përfitues të ndihmës ekonomike, duke ngritur pikëpyetje mbi aksesin e të moshuarve të kësaj zone në skemat e mbështetjes sociale. Duke analizuar aspektin gjinor, gratë dominojnë në numrin e përfituesve të ndihmës ekonomike, me **103 gra krahasuar me 60 burra**. Ky fenomen reflekton jetëgjatësinë më të lartë të grave dhe, njëkohësisht, rritjen e mundësisë për izolim social dhe varësi ekonomike, duke kërkuar ndërhyrje më të synuara në politikat e mbështetjes për këtë kategori.

Në Bashkinë Vau Dejës, njësia administrative me numrin më të lartë të të moshuarve me aftësi të kufizuara është **Bushati**, ku regjistrohen **191 persona**, prej të cilëve **86 janë gra dhe 105 burra**. Kjo njësi përbën **72% të totalit** së të moshuarve me aftësi të kufizuara në bashki, duke reflektuar një nevojë të lartë për mbështetje dhe shërbime të specializuara për këtë grup. Nga ana tjetër, disa njësi të tjera kanë numra më të ulët. **Hajmel, Temal dhe Shllak** raportojnë secila **21 persona** me aftësi të kufizuara, ndërsa në **Vig Mnelë** nuk ka të dhëna për të moshuar në këtë kategori.



Kjo mund të tregojë një mungesë raportimi ose një numër realisht të ulët të të moshuarve me aftësi të kufizuara në këtë zonë. Sa i përket shpërndarjes gjinore, ekziston një **balancë e afërt** midis grave (**135**) dhe burrave (**131**) me aftësi të kufizuara, ndryshe nga grupi

i përfituesve të ndihmës ekonomike, ku gratë përbëjnë shumicën. Ky fakt sugjeron se ndërsa aftësia e kufizuar prek pothuajse në mënyrë të barabartë të dy gjinitë, gratë e moshuara janë më të ekspozuara ndaj sfidave ekonomike dhe sociale, duke reflektuar një nevojë të lartë për shërbime të përshtatura sipas specifikave gjinore dhe shëndetësore.

Akresi në shërbimet shoqërore

Në Bashkinë Vau Dejës është ngritur dhe funksionon shërbimi social "Besa", i cili ofron shërbim rezidencial për të moshuarit. Aktualisht, 25 persona të moshuar, banorë të bashkisë, përfitojnë këtë shërbim në qendrën e menaxhuar nga bashkia me financim nga fondet e saj.

Pavarësisht ekzistencës së këtij shërbimi, mungojnë shërbime të tjera sociale për të moshuarit në nevojë, si shërbimet e kujdesit në shtëpi, qendrat ditore ose programet e integritimit social, duke krijuar një boshllëk në mbështetjen e kësaj kategorie. ***Zhvillimi i alternativave të reja të përkujdesjes mbetet një nevojë emergjente për të siguruar mbështetje të plotë dhe gjithëpërfshirëse për të moshuarit në territorin e bashkisë.***

Sfidat Kryesore

1. ***Mungesa e shërbimeve sociale të dedikuara*** – Nuk ka qendra ditore ose shërbime të specializuara për të moshuarit, as në nivel bashkie dhe as në nivel njësisht administrative.
2. ***Numri i lartë i të moshuarve që jetojnë vetëm*** – 163 të moshuar janë të izoluar dhe shpesh të varur nga ndihmat e shtetit ose familjarëve të largët.
3. ***Mungesa e politikave për integritimin e të moshuarve*** – Nuk ka programe për angazhimin e të moshuarve në aktivitete sociale dhe komunitare.
4. ***Përqindja e lartë e të moshuarve me aftësi të kufizuara*** – 266 persona rezultojnë me aftësi të kufizuara, duke ndikuar në nevojën për shërbime shëndetësore dhe mbështetje sociale.

Individë që kanë varësi nga alkooli

Përdorimi i alkoolit mbetet një problematikë shqetësuese në Bashkinë Vau Dejës, me ndikime të thella në shëndetin publik dhe kohezionin social. Sidoqoftë, mungesa e një databaze të përditësuar dhe të strukturuar nga institucionet vendore e bën të vështirë vlerësimin e plotë të kësaj problematike dhe hartimin e politikave efektive për parandalimin dhe trajtimin e varësisë nga alkooli. Aktualisht, të dhënat mbi këtë fenomen burojnë kryesisht nga Komisariati i Policisë dhe Zyra Vendore e Shërbimit të Kujdesit Shëndetësor, ndërsa Bashkia nuk disponon një regjistër të dedikuar për këtë kategori.

Sipas informacionit të ofruar nga Komisariati i Policisë, në Bashkinë Vau Dejës janë identifikuar 22 persona me varësi nga alkooli, prej të cilëve 20 janë të rritur dhe 2 janë të mitur. Ky fakt tregon se varësia nga alkooli nuk kufizohet vetëm tek të rriturit, por prek edhe të miturit, duke e bërë të nevojshme një ndërhyrje të menjëhershme dhe të strukturuar. Më poshtë paraqiten të dhënat mbi shpërndarjen e rasteve sipas njësive administrative:

	Përdorues viti 2021	Përdorues viti 2022	Përdorues viti 2023
--	---------------------	---------------------	---------------------

Njësia Administrative	Total	Te dhena te policise	Te dhena te Bashkise	Te dhena te shendetesise	Total	Te dhena te policies	Te dhena te Bashkise	Te dhena te shendetesise	Total	Te dhena te policise	Te dhena te Bashkise	Te dhena te shendetesise
Bushat	62	12		50	62	12		50	62	12		50
Vau Dejes	10	10			10	10			10	10		
Hajmel	4	4			4	4			4	4		
Vig Mnel	3	3			3	3			3	3		
Shllak	7	7			7	7			7	7		
Temal	7	7			7	7			7	7		
Total	93	43		50	93	43	0	50	93	43	0	50

Për tre vitet e fundit, nuk rezultojnë raste të referuara nga njësitë administrative, çka tregon për një mungesë të mekanizmave efektivë të identifikimit dhe raportimit të rasteve të varësisë nga alkooli. Ky boshllëk në sistemin e referimit vjen si pasojë e mungesës së një strukture brenda sektorit të shërbimit social në bashki për trajtimin e nevojave të personave të moshuar dhe mungesës së një mekanizmi të qartë bashkëpunimi midis institucioneve, përfshirë mjekët e familjes, strukturat e shëndetësisë dhe shërbimet sociale.

Sfida kryesore dhe nevoja për ndërhyrje

1. **Mungesa e një databaze të strukturuar dhe të unifikuar:** aktualisht, informacioni për individët me varësi nga alkooli vjen nga burime të fragmentuara dhe nuk ka një mekanizëm të centralizuar të raportimit dhe trajtimit të rasteve.
2. **Koordinimi i pamjaftueshëm ndërinstitutional;** institucionet kyçe, si shëndetësia, policia dhe shërbimet sociale, nuk kanë një mekanizëm të rregullt për shkëmbimin e informacionit mbi rastet e varësisë nga alkooli, çka e vështirëson monitorimin dhe ndërhyrjen në kohë.
3. **Mungesa e referimeve nga njësitë administrative;** mungesa e Njësinë e Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN) në Bashkinë Vau Dejës ka krijuar procesi i referimit mbetet i dobët dhe rastet nuk raportohen në mënyrë të strukturuar nga njësitë administrative.
4. **Ndikimi i varësisë nga alkooli tek të miturit;** identifikimi i rasteve të miturve me varësi nga alkooli është një sinjal alarmi për nevojën e masave parandaluese dhe ndërgjegjësuere në shkolla dhe komunitet.
5. **Mungesa e programeve të rehabilitimit dhe mbështetjes sociale;** nuk ekziston një program i strukturuar për rehabilitimin e personave me varësi nga alkooli, duke përfshirë mbështetje psikologjike, trajtim shëndetësor dhe shërbime të specializuara sociale.

Individë që kanë varësi nga droga

Përdorimi i drogës është një shqetësim serioz shëndetësor dhe social në Bashkinë Vau Dejës, megjithatë, mungesa e një sistemi të unifikuar të raportimit dhe të dhënave të strukturuar e vështirëson vlerësimin real të situatës. Të dhënat ekzistuese bazohen kryesisht në raportimet e Komisarariatit të Policisë, ndërsa institucionet e tjera, si Bashkia dhe strukturat shëndetësore, nuk disponojnë një databazë të vetën mbi këtë fenomen. Kjo mungesë e të dhënave nga sektorë

të ndryshëm sugjeron një nën-raportim të mundshëm të rasteve dhe pamundësinë për të ofruar shërbime të specializuara mbështetëse.

Sipas të dhënave të Komisarariatit të Policisë, numri i përdoruesve të drogës në Bashkinë Vau Dejës ka mbetur konstant gjatë tre viteve të fundit, me një total prej 15 personash të identifikuar. Këta përdorues janë shpërndarë në disa njësi administrative, ndërsa në disa zona, si Vig Mnel dhe Temal, nuk ka raste të raportuara.

Njësia Administrative	Përdorues viti 2021				Përdorues viti 2022				Përdorues viti 2023			
	Total	Te dhena te	Te dhena te	Te dhena te	Total	Te dhena te	Te dhena te	Te dhena te	Total	Te dhena te	Te dhena te	Te dhena te
Bushat	5	5	0	0	5	5	0	0	5	5	0	0
Vau Dejës	4	4	0	0	4	4	0	0	4	4	0	0
Hajmel	3	3	0	0	3	3	0	0	3	3	0	0
Vig Mnel	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Shllak	3	3	0	0	3	3	0	0	3	3	0	0
Temal	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0	0
Total	15	15	0	0	15	15	0	0	15	15	0	0

Nga analiza e të dhënave vërehet:

- ✓ Mungesa e ndryshimeve në shifrat e raportuara për tre vite radhazi sugjeron ose një nivel konstant të problemit ose një mungesë efektive të mekanizmave të identifikimit dhe raportimit të rasteve të reja.
- ✓ Përqendrimi i rasteve në Bushat, Vau Dejës dhe Hajmel, ndërkohë që në Vig Mnel dhe Temal nuk ka raste të raportuara, mund të tregojë mungesë vëzhgimi dhe raportimi efektiv në këto zona.
- ✓ Mungesa e të dhënave nga strukturat shëndetësore dhe Bashkia tregon për një boshllëk të theksuar në monitorimin dhe trajtimin e rasteve të përdorimit të substancave narkotike nga këto institucione.

Sfida kryesore në trajtimin e fenomenit

1. **Mungesa e një databaze të përbashkët;** aktualisht, të dhënat për përdoruesit e drogës janë të kufizuara vetëm tek raportimet e policisë, ndërsa Bashkia dhe institucionet e shëndetësisë nuk mbledhin apo analizojnë informacione për këtë grup.

2. **Nën-raportimi i rasteve**; numri i qëndrueshëm i përdoruesve të drogës në tre vitet e fundit tregon se mund të ketë një mungesë të identifikimit aktiv të rasteve të reja, veçanërisht nga mjekët e familjes dhe institucionet arsimore.
3. **Mungesa e shërbimeve të specializuara**; në Bashkinë Vau Dejës nuk ekzistojnë struktura apo programe të posaçme për rehabilitimin e përdoruesve të substancave narkotike, si qendrat e trajtimit apo mbështetjes psikosociale.
4. **Koordinimi i dobët ndërinstitucional**; nuk ka një mekanizëm efektiv bashkëpunimi midis policisë, shërbimeve sociale, mjekëve të familjes dhe shkollave për të identifikuar dhe mbështetur përdoruesit e drogës në komunitet.
5. **Ndikimi te të rinjtë**; edhe pse nuk ka të dhëna specifike mbi moshën e përdoruesve, problematika e drogës zakonisht prek të rinjtë dhe adoleshentët, duke rritur nevojën për masa parandaluese në shkolla dhe komunitet.

Persona LGBTIQ+

Në Bashkinë Vau Dejës, mungojnë të dhëna të strukturuar dhe të besueshme mbi personat LGBTIQ+, pasi asnjë institucion lokal nuk ka kryer identifikim apo raportim mbi këtë kategori. Kjo mungesë informacioni tregon për një boshllëk në kuptimin dhe adresimin e nevojave specifike të personave LGBTIQ+, si dhe për një mungesë të mekanizmave për të siguruar përfshirjen e tyre në politikat sociale. Pa një vlerësim të saktë të situatës, është e vështirë të përcaktohet niveli i diskriminimit, sfidat sociale apo përjashtimi nga shërbimet, çka mund të ndikojë në cilësinë e jetës dhe të drejtat e tyre.

Në këtë kontekst, është e nevojshme që Bashkia Vau Dejës të marrë masa për të krijuar një kuadër institucional që garanton mbrojtjen dhe përfshirjen e personave LGBTIQ+ në programet sociale. Kjo përfshin sensibilizimin e institucioneve lokale mbi të drejtat dhe nevojat e kësaj kategorie, krijimin e mekanizmave për raportimin e diskriminimit dhe integrimin e një qasjeje gjithëpërfshirëse në hartimin e politikave sociale. Gjithashtu, bashkëpunimi me organizatat e shoqërisë civile dhe institucionet kombëtare mund të ndihmojë në sigurimin e një kuadri më të qartë për adresimin e sfidave që mund të përjetojnë personat LGBTIQ+ në komunitet.

Vlerësimi i nivelit aktual të shërbimeve

Bashkia Vau Dejës përballlet me sfida të mëdha në ofrimin e shërbimeve sociale për grupet më të cënueshme. Aktualisht, mbulimi me shërbime është i ulët, me vetëm 61 persona me aftësi të kufizuara (4.93%), 10 fëmijë në nevojë për mbrojtje (1.01%) dhe 25 persona të moshuar * (0.59%), që përfitojnë shërbime, ndërsa kategori të tjera si viktimat e dhunës dhe individët me varësi nuk marrin mbështetje të strukturuar. Kjo situatë kërkon një ndërhyrje të integruar dhe strategjike për të garantuar akses të barabartë në shërbime dhe për të forcuar mekanizmat mbështetës për grupet vulnerabël. Tabela e mëposhtme prezanton nivelin e mbulimit me shërbime shoqaërore të grupeve në nevojë:

Kategoria në nevojë	Popullsia në Nevojë	Përfitues të Shërbimeve Shoqërore	Mbulimi në shërbime në %
---------------------	---------------------	-----------------------------------	--------------------------

Fëmijë në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje	987	10	1.01%
Të moshuar	4237	25	0.59%
Persona me aftësi të kufizuara	1238	61	4.93%
Viktima të dhunës në familje	8	0	0.00%
Familje në nevojë për strehim social		3	
Individë me varësi nga alkooli	93	0	0.00%
Individë me varësi nga droga	15	0	0.00%
Personat LGBTIQ+	0	0	0.00%
Total	6678	99	9.50%

a) Vlerësimi i nevojave për kategoritë vulnerabël

Fëmijët në nevojë për mbrojtje dhe përkujdesje

- Vetëm 1.01% e fëmijëve në nevojë marrin shërbime sociale.
- Mungojnë programe parandaluese për dhunën dhe braktisjen.
- Kërkohet rritje e shërbimeve të integruara dhe ngritja e çerdheve.

Të moshuarit në nevojë për përkujdesje

- Shërbimet ekzistuese mbulojnë vetëm 0.59% të tyre.
- Mungojnë qendrat ditore dhe shërbimet e personalizuara.
- Kërkohet zhvillimi i shërbimeve të lëvizshme dhe mbështetje në familje.

Personat me Aftësi të Kufizuara

- Vetëm 4.93% marrin shërbime të specializuara.
- Nevojitet zgjerimi i programeve të mbështetjes dhe riintegrimi social.

Viktimat e dhunës

- Asnjë viktimë nuk ka përfituar shërbime (0%).
- Kërkohet ndërtimi i një mekanizmi të strukturuar për identifikimin dhe mbështetjen e tyre.

Familjet në nevojë për strehim social

- Vetëm 3 familje kanë përfituar shërbime strehimi.
- Nevojitet zgjerimi i skemave të bonusit të qirasë dhe politikave mbështetëse.

Individët me Varësi nga Alkooli dhe Droga

- Asnjë individ nuk ka përfituar shërbime (0%).
- Nuk ka programe të dedikuara për rehabilitimin e tyre.
- Kërkohet ngritja e mekanizmave për trajtimin dhe integrimin e tyre.

Personat LGBTIQ+

- Mungon një strategji gjithëpërfshirëse dhe identifikimi i nevojave specifike.
- Nevojitet krijimi i shërbimeve të dedikuara dhe promovimi i barazisë sociale.

b) **Bashkëpunimi me Aktorët Lokalë dhe Shoqërinë Civile**

Bashkia Vau Dejës ka ndërtuar partneritete të rëndësishme me organizata që ofrojnë mbështetje për grupet më të cënueshme, duke përmirësuar aksesin në shërbime. Ndër organizatat aktive janë:

- **Vëllezërit e Nënë Terezës**, të cilët ofrojnë shërbime sociale për personat me aftësi të kufizuara mbi 18 vjeç.
- **Zyra për Djemtë dhe Burrat**, e cila promovon barazinë gjinore dhe fuqizimin social.
- **Hapa të Lehtë**, që ofron strehim të përkohshëm, mbështetje psikologjike dhe ndihmë ligjore për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës.
- **Gruaja tek Gruaja**, që ofron strehim të përkohshëm, mbështetje psikologjike dhe ndihmë ligjore për gratë dhe fëmijët viktimë të dhunës.
- **Komuniteti Papa Gjovani XXII**, që ofron mbrojtje dhe rehabilitim për viktimat e dhunës në familje, nëpërmjet sistemit pranë Strehzës “Shtëpi Mikpritëse Santa Maria”, qendër rezidenciale e licensuar për ofrimin e shërbimeve shoqërore për vajza, gra dhe nëna me fëmijë, viktimë të dhunës në familje,,

Nënshkrimi i **Kontratës Sociale 2023-2027** me organizatën **Hapa të Lehtë** rikonfirmon angazhimin e bashkisë për drejtësi sociale dhe përmirësimin e jetës së qytetarëve në nevojë.

c) **Rekomandime për përmirësimin e shërbimeve sociale**

1. **Ngritja e një Qendre Multidisiplinare** për familjet dhe individët në nevojë, e cila do të ofrojë shërbime të integruara për fëmijët, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe viktimat e dhunës.
2. **Ofrimi i shërbimeve të lëvizshme dhe në familje** për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara, duke siguruar kujdes të personalizuar.
3. **Zgjerimi i shërbimeve ekzistuese**, përfshirë mbrojtjen e fëmijëve, skemat e ndihmës sociale dhe mbështetjen për viktimat e dhunës.
4. **Ndërtimi i modeleve për fuqizimin e grupeve vulnerabël**, duke u fokusuar te gratë, të rinjtë dhe personat në nevojë për punësim.
5. **Pilotimi i shërbimeve ditore për të moshuarit** në çdo njësi administrative për të parandaluar izolimin dhe për të promovuar një jetë aktive.

Zbatimi i këtyre masave do të mundësojë një qasje më të drejtë dhe efektive ndaj shërbimeve sociale, duke ofruar mundësi të barabarta për të gjithë qytetarët e Bashkisë Vau Dejës.

Analiza e burimeve njerëzore

Burimet njerëzore në sektorin e shërbimeve shoqërore të Bashkisë Vau Dejës janë të kufizuara, duke ndikuar drejtpërdrejt në ofrimin e mbështetjes për grupet më të cënueshme. Struktura aktuale e stafit përqendrohet kryesisht në administrimin e ndihmës ekonomike dhe aftësisë së kufizuar, ndërkohë që mungojnë specialistë të dedikuar për çështje të tilla si dhuna në familje, rehabilitimi i personave me varësi, apo përkujdesja sociale për të moshuarit dhe personat me aftësi të kufizuara. **Mungesa e Njesisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN)**

krijon një boshllëk të rëndësishëm në sistemin e menaxhimit të rasteve sociale, duke e bërë të vështirë identifikimin dhe referimin e personave në nevojë drejt shërbimeve të specializuara.

Numri i punonjësve socialë dhe specialistëve mbetet i pamjaftueshëm në raport me nevojat e popullsisë. Aktualisht, një numër i kufizuar punonjësish mbulon të gjithë territorin e bashkisë, duke penguar një reagim të shpejtë dhe efektiv ndaj rasteve emergjente sociale. Për shembull, me mbi **4,237 të moshuar**, vetëm një pjesë shumë e vogël merr mbështetje për shkak të mungesës së stafit të mjaftueshëm. Një problem tjetër është mungesa e specializimit brenda stafit ekzistues, pasi shumica e punonjësve socialë janë të përfshirë kryesisht në administrimin e skemave të ndihmës ekonomike, duke lënë hapësirë të kufizuar për trajtimin e rasteve sociale më komplekse.

Për të adresuar këto sfida, **krijimi i Njësisë së Vlerësimit dhe Referimit të Nevojave (NJVRN)** është një hap thelbësor për rritjen e efektivitetit të shërbimeve sociale. Kjo njësi duhet të përfshijë specialistë të fushave të ndryshme, të cilët do të mund të vlerësojnë rastet sociale dhe t'i referojnë ato tek institucionet dhe shërbimet përkatëse. Gjithashtu, **shtimi i personelit dhe specializimi i tyre sipas kategorive të nevojës** do të ndihmonte në përmirësimin e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve shoqërore në Bashkinë Vau Dejës. Përmes këtyre ndërhyrjeve, bashkia mund të krijojë një sistem më të strukturuar dhe të integruar, duke garantuar një mbështetje më të madhe për qytetarët në nevojë.

Analiza SWOT për realizimin e Planit Social Lokal në Bashkinë Vau Dejës

Analiza SWOT për realizimin e Planit Social Lokal në Bashkinë Vau Dejës ofron një vlerësim të thelluar të faktorëve që ndikojnë në zhvillimin e shërbimeve sociale. Pikat e forta si partneritetet me organizata, përvoja në projektet sociale dhe potenciali për punësim krijojnë një bazë të mirë për përmirësimin e situatës. Megjithatë, dobësitë si mungesa e të dhënave të detajuara dhe kapacitetet e kufizuara institucionale përbëjnë sfida serioze. Në të njëjtën kohë, ekzistojnë mundësi të rëndësishme për zhvillimin e shërbimeve komunitare dhe rritjen e financimeve, por këto duhen parë përballë kërcënimeve si emigrimi, mungesa e fondeve të qëndrueshme dhe burokracia..

Pikat e Forta

1. **Partneritete me organizata:** Bashkia ka ndërtuar bashkëpunime me aktorë lokalë si **Vëllezërit e Nënë Terezës, Hapa të Lehtë dhe Zyra për Djemtë dhe Burrat, Gruaja tek Gruaja, Komuniteti Papa Xhovani XXIII** të cilët ofrojnë mbështetje për grupet vulnerabël.
2. **Potenciali për punësim në sektorët ekonomikë kryesorë:** Bujqësia, blegtoria dhe turizmi mund të shërbejnë si baza për krijimin e programeve të punësimit dhe trajnimeve profesionale.
3. **Përvojë në zbatimin e projekteve sociale:** Bashkia ka një historik të angazhimit në projekte sociale, duke siguruar fonde për ndihmën ekonomike dhe programe mbështetëse.
4. **Vullneti institucional:** Ka një angazhim të qartë të bashkisë për përmirësimin e shërbimeve sociale dhe përfshirjen e grupeve vulnerabël në planifikimin e politikave lokale.
5. **Mundësia për qasje në financime:** Ka burime të mundshme financimi nga donatorët, organizatat ndërkombëtare dhe qeveria për të mbështetur implementimin e planit.

Dobësitë

1. **Mungesa e të dhënave të detajuara:** Nuk ka një bazë të dhënash të plotë për nevojat specifike të grupeve vulnerabël, çka pengon planifikimin e saktë të shërbimeve.
2. **Mungesa e shërbimeve të dedikuara:** Viktimat e dhunës, personat me varësi nga substancat dhe grupet e tjera në nevojë nuk kanë mbështetje të strukturuar.
3. **Kapacitetet e kufizuara institucionale:** Stafi i shërbimeve sociale është i pamjaftueshëm për të mbuluar nevojat e komunitetit në të gjitha njësitet administrative.
4. **Papunësia dhe mungesa e trajnimeve profesionale:** Me 62.4% të të papunëve që kanë vetëm arsim 9-vjeçar, mundësitë për integrim në tregun e punës janë të ulëta.
5. **Mungesa e qendrave të shërbimeve sociale:** Nuk ka qendra ditore për të moshuarit apo qendra multidisciplinare për familjet në nevojë.

Mundësitë

1. **Zhvillimi i shërbimeve komunitare:** Mund të krijohen **qendra ditore për të moshuarit, qendra multidisciplinare për mbështetjen e familjeve dhe programe të integruara për grupet vulnerabël.**
2. **Zgjerimi i partneriteteve me shoqërinë civile dhe sektorin privat:** Bashkia mund të bashkëpunojë me bizneset dhe organizatat jofitimprurëse për të ofruar mbështetje për punësimin dhe shërbimet sociale.
3. **Përdorimi i teknologjisë për akses në shërbime:** Mund të zhvillohen **platforma online për ndihmën sociale**, si dhe mekanizma digjitalë për raportimin dhe monitorimin e rasteve të dhunës dhe varfërisë.
4. **Financimi nga programet kombëtare dhe ndërkombëtare:** Fondet e BE-së dhe qeverisë shqiptare mund të mbështesin implementimin e planit social dhe zhvillimin e infrastrukturës së nevojshme.
5. **Përfshirja e komunitetit në vendimmarrje:** Rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirja aktive e qytetarëve në hartimin dhe monitorimin e politikave sociale do të përmirësonte efikasitetin e ndërhyrjeve.

Kërcënimet

1. **Mungesa e fondeve të qëndrueshme:** Nëse financimi i shërbimeve mbetet i kufizuar, zbatimi i masave sociale do të jetë i vështirë dhe afatshkurtër.
2. **Emigrimi dhe plakja e popullsisë:** Largimi i të rinjve dhe rritja e numrit të të moshuarve pa përkujdesje mund të rëndojnë sistemin e shërbimeve sociale.
3. **Burokracia dhe vonesat në miratimin e projekteve:** Procedurat e gjata administrative mund të pengojnë zbatimin e masave të reja dhe alokimin e burimeve financiare.
4. **Stigma sociale për disa kategori:** Disa grupe, si personat LGBTIQ+ dhe individët me varësi, përballen me vështirësi në pranimin dhe përfshirjen në programet sociale.
5. **Ndryshimet politike dhe prioritetet institucionale:** Ndryshimet e politikave qeveritare ose në nivel bashkiak mund të ndikojnë në financimin dhe prioritetet e planit social.

Analiza SWOT tregon se, pavarësisht potencialeve të Bashkisë Vau Dejës për të zhvilluar një sistem më të fortë të shërbimeve sociale, ka ende sfida që duhen adresuar për të garantuar një qasje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse. Shfrytëzimi i partneriteteve, rritja e burimeve financiare dhe përmirësimi i kapaciteteve institucionale mund të ndihmojnë në minimizimin e dobësive dhe përballimin e kërcënimeve. Planifikimi strategjik dhe një qasje e mirëkoordinuar

do të jenë thelbësore për të maksimizuar mundësitë dhe për të siguruar mbështetje efektive për grupet vulnerabël.

III. QËLLIMET DHE OBJEKTIVAT

Qëllimi i Përgjithshëm është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të aksesueshëm të mbrojtjes sociale që adreson në mënyrë efektive nevojat e individëve dhe familjeve në rrezik përjashtimi social.

Nëpërmjet forcimit të kapaciteteve institucionale, zgjerimit të shërbimeve sociale dhe zhvillimit të programeve të reja për fuqizimin e grupeve vulnerabël, synohet të sigurohet përfshirja, mbrojtja dhe integrimi i tyre në jetën shoqërore dhe ekonomike.

Objektivat specifike për të siguruar shërbime cilësore për komunitetin e Bashkisë Vau Dejës janë:

Objektivi specifik 1 (OS1): Përmirësimi i kapaciteteve institucionale për ofrimin e shërbimeve sociale.

Masa 1: Strukturimi dhe modernizimi institucional

A 1.1 Analizë e funksionimit aktual të sektorit social dhe identifikimi i nevojave për riorganizim.

A 1.2 Hartimi dhe miratimi i një plani për ristrukturimin e shërbimeve sociale.

A 1.3 Krijimi dhe fuqizimi i Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NjVNR) për një qasje më efektive.

Masa 2: Rritja e kapaciteteve të stafit

A 2.1 Organizimi i trajnimeve të detajuara për punonjësit socialë dhe administratën e sektorit mbi vlerësimin e nevojave dhe menaxhimin e rasteve.

A 2.2 Përdorimi i shkëmbimeve të përvojave me bashki të tjera për ndarjen e praktikave më të mira.

Masa 3: Krijimi i një mekanizmi për mbledhjen dhe përditësimin e informacionit mbi nevojat sociale

A 3.1 Krijimi i një databaze digjitale për regjistrimin dhe përditësimin e rasteve në nevojë.

A 3.3 Zhvillimi i një mekanizmi raportimi për punonjësit socialë dhe administratorët shoqërore për të reflektuar ndryshimet në nevojat e komunitetit.

Masa 4: Bashkëpunimi me sektorin privat dhe OJQ-të për mbështetjen e shërbimeve sociale

A 4.1 Organizimi i tryezave të rrumbullakëta për koordinimin mes bashkisë, OJQ-ve dhe sektorit privat.

A 4.2 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit për financimin dhe zgjerimin e shërbimeve sociale.

A 4.3 Organizimi i një forumi vjetor për partneritetin social për të vlerësuar rezultatet dhe strategjitë e ardhshme.

Fondi i nevojshëm për realizimin e Objektivit të Parë është 5,637,512 ALL, nga të cilët 4,790,512 lekë mbulohen nga Bashkia me fondet e veta (kryesisht paga të stafit të bashkisë) dhe 847,000 ALL kërkojnë mbulim nga donator.

Objektivi specifik 2: Rritja e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve sociale për grupet vulnerabël

Masa 1: Krijimi dhe funksionalizimi i qendrave multifunksionale për ofrimin e shërbimeve sociale

A 1.1 Ngritja e qendres se shërbimit multifunksional ne Bashkine Vau Dejes grupet në nevojë.

- ✓ A 1.1.1 Rikonstrukcioni i ambjentit
- ✓ A 1.1.2 Rekrutimi i stafit të qendres
- ✓ A 1.1.3 Qendra ofron shërbime për 30 familje ne nevojë dhe 60 persona ne nevojë

A 1.2 Krijimi i shërbimeve të integruara mbështetëse si këshillimi psikologjik, asistencë juridike dhe ndihma sociale.

Masa 2: Implementimi i shërbimeve në shtëpi dhe të lëvizshme për komunitetet rurale dhe të largëta

A 2.1 Identifikimi i zonave të largëta me mungesë shërbimesh sociale.

A 2.2 Ngritja dhe funksioni i ofrimit të shërbimeve në shtëpi për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe individët pa akses në qendra sociale.

Masa 3 Zgjerimi dhe përmirësimi i shërbimeve sociale ekzistuese.

A 3.1 Qendra rezidenciale për moshën e tretë Besa ofron shërbime shoqërore

A 3.2 Shërbime për fëmijë

A 3.3 Vëlon shërbimi rezidencial për personat me Ak mbi personat 65+ vjeç

Masa 4: Krijimi dhe administrimi i Fondit Social të Bashkisë

A 4.1 Hartimi i një rregulloreje për krijimin dhe përdorimin e Fondit Social.

A 4.2 Identifikimi i burimeve të financimit nga buxheti vendor, donatorët dhe sektori privat

A 4.3 Financimi i projekteve inovative për përmirësimin e shërbimeve sociale.

Fondi i nevojshëm për realizimin e Objektivit të Dytë është 120,619,887 ALL, nga të cilët 43,504,844 lekë mbulohen nga Bashkia me fondet e veta (kryesisht paga të stafit të bashkisë) dhe 77,115,043 ALL kërkojnë mbulim nga donator.

Objektivi specifik 3: Informimi, edukimi dhe fuqizimi i grupeve vulnerabël

Masa 1: Hartimi dhe zbatimi i një plani efektiv për informim dhe ndërgjegjësim

A 1.1 Hartimi dhe shpërndarja e materialeve vizuale dhe digjitale informuese.

A 1.2 Organizimi i fushatave ndërgjegjëse në shkollë, qendra komunitare dhe hapësira publike.

A 1.3 Bashkëpunimi me media lokale për shpërndarjen e informacioneve edukative.

Masa 2: Mbështetje për familjet me të ardhura të ulëta për fuqizimin ekonomik

A 2.1 Subvencione për trajnime profesionale për grupet vulnerabël.

A 2.2 Mbështetje për krijimin e bizneseve të vogla për familjet me të ardhura të ulëta.

Masa 3: Zhvillimi i programeve për fuqizimin e grave dhe të rinjve në vështirësi

A 3.1 Programe aftësimi profesional dhe mentorimi për gratë dhe të rinjtë në vështirësi.

A 3.2 Krijimi i një skeme mbështetëse për sipërmarrjet sociale të grave dhe të rinjve.

A 3.3 Bashkëpunimi me sektorin privat për të lehtësuar punësimin e grupeve vulnerabël.

Fondi i nevojshëm për realizimin e Objektivit të Tretë është 1,470,000 ALL, nga të cilët mbulohen nga Bashkia me fondet e veta (kryesisht paga të stafit të bashkisë)

Fondi i nevojshëm për realizimin e Planit Lokal Social

Objektivi Specifik	Fondi I nevojshëm	Burimi Financimit	
		Bashkia	Donatore
OS 1	5,637,512	4,790,512	847,000
OS 2	120,619,887	43,504,844	77,115,043
OS 3	1,470,000	1,470,000	-
Total	127,727,399	49,765,356	77,962,043

IV. PLANI I VEPRIMIT

MATRICA E PLANIT VENDOR SOCIAL BASHKIA VAU DEJES

Qëllimi i Përgjithshëm është krijimi i një sistemi të qëndrueshëm dhe të aksesueshëm të mbrojtjes sociale që adreson në mënyrë efektive nevojat e individëve dhe familjeve në rrezik përjashtimi social.

Objektivi specifik 1 (OS1): Përmirësimi i kapaciteteve institucionale për ofrimin e shërbimeve sociale

Objektivat	Aktiviteti	Indikatori	Afati i zbatimit		Buxheti dhe Burimi I financimit	Institucionet përgjegjëse	
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/S ektori/Departamenti(Udheheqes)	Institucion kontribues (nese ka)
Objektivi specifik 1 (OS1): Përmirësimi i kapaciteteve institucionale për ofrimin e shërbimeve sociale.							

Masa 1: Strukturimi dhe modernizimi institucional	A 1.1 Analizë e funksionimit aktual të sektorit social dhe identifikimi i nevojave për riorganizim.	Një raport I hartuar	2025	2025	37.953,00 ALL Fondi Bashkise	Drejtoria Burimeve Njerezore ; Drejtoria e sherbimeve sociale dhe Drejtoria Juridike	OJF
	A 1.2 Hartimi dhe miratimi i një plani për ristrukturimin e shërbimeve sociale.	i) Rishikimi I struktures se Drejtorise se Sherbimeve Sociale; ii)Miratimi I rregullores dhe struktures se re te Drejtorise se Sherbimeve Sociale	2025	2025	126,510.00 ALL Fondi Bashkise	Drejtoria Burimeve Njerezore ; Drejtoria e sherbimeve sociale dhe Drejtoria Juridike	OJF

	A 1.3 Krijimi dhe fuqizimi i Njësive të Vlerësimit të Nevojave dhe Referimit (NjVNR) për një qasje më efektive.	Ngrihet NJVRN, një punonjes I Drejtorise se Sherbimeve Sociale luan rolin e NJVRN	2025	2025	1087986 ALL vit/ Fondet e Bashkise	Drejtoria Burimeve Njerezore ; Drejtoria e sherbimeve sociale dhe Drejtoria Finances	Institucioneve lokale dhe OJF
Masa 2: Rritja e kapaciteteve të stafit	A 2.1 Organizimi i trajnimeve të detajuara për punonjësit socialë dhe administratën e sektorit mbi vlerësimin e nevojave dhe menaxhimin e rasteve.	1 Moduli I trajnimit I realizuar	2025	2026	150,000 All /Donator I pambuluar	Drejtoria Burimeve Njerezore ; Drejtoria e sherbimeve sociale	OJF
		4 seanca trajnimi nje ditore per NJVRN			75,000 All/Donator I pambuluar		
	A 2.2 Përdorimi i shkëmbimeve të përvojave me bashki të tjera për ndarjen e praktikave më të mira.	3 Aktivitete te realizuar , 5 punonjes	2025	2028	21085 All / Fondi I Bashkise	Drejtoria Burimeve Njerezore ;	Bashki te tjera dhe OJF

		marrin pjese ne aktivite			25000 All/Fondi I Bashkise	Drejtoria e sherbimeve sociale	
Masa 3: Krijimi i një mekanizmi për mbledhjen dhe përditësimin e informacionit mbi nevojat sociale	A 3.1 Krijimi i një databaze digjitale për regjistrimin dhe përditësimin e rasteve në nevojë.	Data baza e ngritur dhe funksionale	2025	2026	126,510.00 ALL Fondi I Bashkise	Drejtoria e Sherbimeve e Sociale dhe Departamenti I IT	OJF
	A 3.2 Zhvillimi i një mekanizmi raportimi për punonjësit socialë dhe administratoret shoqerore për të reflektuar ndryshimet në nevojat e komunitetit.	Eshte hartuar protokolli I perdorimit te databazes dhe zbatohet nga stafi I bashkise	2026	2028		Drejtoria e Sherbimeve e Sociale	OJF
Masa 4: Bashkëpunimi me sektorin privat dhe OJQ-të për	A 4.1 Organizimi i tryezave të rrumbullakëta për koordinimin mes bashkisë, OJQ-ve dhe sektorit privat.	6 tryeza te realizuara ne vit, 120 persona marrin pjese ne aktivitet (6 tryeza x 20 pers /tryeze)	2025	2028	151,812.00 ALL/vit Fondi Bashkise	Drejtoria e Sherbimeve e Sociale	Institucione lokale dhe OJF

mbështetjen e shërbimeve sociale					36,000.00 ALL /vit Donator I pambuluar		
					90,000.00 ALL/vit Donator I pambuluar		
	A 4.2 Nënshkrimi i marrëveshjeve të bashkëpunimit për financimin dhe zgjerimin e shërbimeve sociale.	3 marreveshjeve te nenshkruara	2025	2028		Drejtoria e Sherbimev e Sociale dhe Drejtoria Juridike	OJF
	A 4.3 Organizimi i një forumi vjetor për partneritetin social për të vlerësuar rezultatet dhe strategjitë e ardhshme.	Nje forum vjetor I realizuar cdo vit	2025	2028		Drejtoria e Sherbimev e Sociale	Instituci one Lokale dhe OJF
TOTAL					2,072,111.00 ALL		

Objektivi specifik 2 (OS2): Rritja e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve sociale për grupet vulnerabël

Objektivat	Aktiviteti	Indikatori	Afati i zbatimit		Buxheti dhe Burimi financimit	Institucionet përgjegjëse	
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/S ektori/Departamenti(U dheheqes)	Institucion kontribues (nese ka)
Objektivi specifik 2: Rritja e aksesit dhe cilësisë së shërbimeve sociale për grupet vulnerabël							
Masa 1: Krijimi dhe funksionalizimi i qendrave multifunksionale për ofrimin e shërbimeve sociale	A 1.1 Ngritja e qendres se shërbimit multifunksional ne Bashkine Vau Dejesgrupet në nevojë.						
	A 1.1.1 Rikonstruksioni i ambjentit	Ambjenti i rikonstruktuar dhe mobiluar ne fuksion te ofrimit te sherbimit	2025	2026	20000000/fondi donator	Drejtoria Urbanistike s , Drejtoria sherbimit social	Donatore te ndryshem (nese ka)

	A 1.1.2 Rekrutimi i stafit të qendres	7 persona te punesuar	2025	2028	25,302.00 ALL/ Fondi I Bashkise	Drejtoria e burimeve njerezore dhe Drejtoria sherbimit social	OJF
	A 1.1.3 Qendra ofron sherbime per 30 familje ne nevoje dhe 60 persona ne nevoje	30 familje dhe 60 persona ne nevoje (te mitur, te moshuar, PAK, viktima te dhunes etj)marrin sherbime ditore	2026	2028	9,500,000.00 All ne vit/ Donator I pambuluar	Drejtoria e sherbimeve sociale	Donator e te ndryshem (nese ka)
	A 1.2 Krijimi i shërbimeve të integruara mbështetëse si këshillimi psikologjik, asistenca juridike dhe ndihma sociale.	30 persona ne vit ne nevoje perfitojne sherbime	2026	2028	759,060 ALL ne vit/Fondi I Bashkise	Drejtoria e sherbimeve sociale	OJF
Masa 2: Implementimi i shërbimeve në shtëpi dhe të lëvizshme për komunitete	A 2.1 Identifikimi i zonave të largëta me mungesë shërbimesh sociale.	Jane identifikuar rastet dhe nevojat e tyre per sherbime ne famije, eshte pergatitur dhe miratuar lista e personave qe kane nevoje urgjente per sherbime	2025		202,418.00 All /Fondi I Bashkise	Drejtoria e sherbime sociale dhe administratoret shoqerore ne 6 njesite administrative	Institucione Lokale dhe OJF

t rurale dhe të largëta	A 2.2 Ngritja dhe funksioni i ofrimit të shërbimeve në shtëpi për të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara dhe individët pa akses në qendra sociale.	25 persona (të moshuar ose PAK) marrin shërbim në shtëpi javë	2025	2028	9,000,000 All në vit Donator I pambuluar	Drejtoria e shërbimeve sociale	Zyra Vendor e Kujdesit Shëndetësor OJF
Masa 3 Zgjerimi dhe përmirësimi i shërbimeve sociale ekzistuese.	A 3.1 Qendra rezidenciale për moshën e tretë Besa ofron shërbime shoqërore	Numri persona marrin shërbim në qendër	2025	2028	21175918 në vit/ Fondi I Bashkise	Drejtoria e shërbimeve sociale	Zyra Vendor e Kujdesit Shëndetësor OJF
	A 3.2 Shërbime për fëmijë	10 fëmijë marrin shërbim	2025	2028	Donator me burimet e veta	NJMF	Zyra Vendor e Arsimit dhe Zyra për djem dhe burra

	A 3.3 Vijon sherbimi rezidencial per personat me Ak mbi personat 65+ vjec	36 persona arrin sherbim ne qender	2025	2028	Donator me burimet e veta		Bashkia ; Zyra Vendor e e Kujdesi t Shendet esor dhe Vellerez it e Nene Terezes
Masa 4: Krijimi dhe administri mi i Fondit Social të Bashkisë	A 4.1 Hartimi i një rregulloreje për krijimin dhe perdorimit e Fondit Social.	Rregullore e miratuar me vendim te Keshillit Bashkiak	2025	2026	33,736 All/Fonde e bashkise	Drejtoria juridike dhe drejtoria e sherbimit social	OJF
	A 4.2 Identifikimi i burimeve të financimit nga buxheti vendor, donatorët dhe sektori privat	Liste e donatoreve te mundeshem dhe sektori privat e hartuar	2025	2026	33,736 All/Fonde e bashkise	Drejtoria juridike dhe drejtoria e sherbimit social	OJF
	A 4.3 Financimi i projekteve inovative për përmirësimin e shërbimeve sociale.	Miratohet procedura per aplikim te OJF per financimin e sherbimeve sociale inovatore	2025	2026	33,736 All/Fonde e bashkise	Drejtoria juridike dhe drejtoria e sherbimit social	OJF

		Bashkia Parashikon dhe planifikon fonde per sherbime inovatore dhe sherbime te reja	2026	2028	12,000,000 All /Fondi Social I Bashkise	Drejtoria juridike dhe drejtoria e sherbimit social	OJF
	Totali				120,619,887		

Objektivi specifik 3 (OS3) : Informimi, edukimi dhe fuqizimi i grupeve vulnerabël

Objektivat	Aktivitete	Indikatori	Afati i zbatimit		Buxheti dhe Burimi financimit	Institucionet përgjegjëse	
			Afati i fillimit	Afati i mbarimit		Drejtoria/Sektori/Departamenti(Udhëheqes)	Institucion kontribuues (nëse ka)
Objektivi specifik 3: Informimi, edukimi dhe fuqizimi i grupeve vulnerabël							

Masa 2: Mbështetje për familjet me të ardhura të ulëta për fuqizimin ekonomik	A 2.1 Subvencione për trajnime profesionale për grupet vulnerabël.	Fonde te planifikuara per mbulimin e transportit per ndjekjen e kurseve te formimit profesional per jo me shume se 6 persona, anetare te familjeve me te ardhura te ulta ne vit	2026	2028	135,000 All/Fondi I Bashkise	Drejtoria e sherbimeve sociale dhe drejtoria e finances	Donator e
	A 2.2 Mbështetje për krijimin e bizneseve të vogla për familjet me të ardhura të ulëta.	Fonde te planifikuara per mbeshtetjen e 3 bizneseve te reja per familjet me te ardhura te ulta (nje biznes ne vit	2026	2028	600,000 All/Fondi I Bashkise	Drejtoria e sherbimeve sociale dhe drejtoria e finances	QFP Shkoder
Masa 3: Zhvillimi i programev e për fuqizimin e grave dhe	A 3.1 Programe aftësimi profesional dhe mentorimi për gratë dhe të rinjtë në vështirësi.	i) Marrveshje e nenshkruar me Qendren e Formimit profesional	2025	2026		Drejtoria Juridike dhe Drejtori e Sherbimit Social	QFP Shkoder

të rinjve në vështirësi		ii) Fonde te planifikuara per mbulimin e transportit per ndjekjen e kurseve te formimit profesional per jo me shume se 6 persona (3 djem dhe tre vajza)	2026	2028	135,000 All/Fondi I Bashkise	Drejtoria e sherbimeve sociale dhe drejtoria e finances	QFP Shkoder
		iii) 2 kurse formimi profesional te zhvilluara ne territorin e Bashkise Vau Dejes dhe 20 te rinj dhe gra ndjekun kurset profesionale	2026	2028		Drejtoria e sherbiit social	QFP Shkoder
	A 3.2 Krijimi i një skeme mbështetëse për sipërmarrjet sociale të grave dhe të rinjve.	2 Kursante mbeshteten nga bashkia pas perfundimit te kurseve per nisjen e biznesit	2026	2028	600,000 All/Fondi I Bashkise	Drejtoria e Sherbimit Social ne Bashkie dhe Drejtoria e Finances	

	A 3.3 Bashkëpunimi me sektorin privat për të lehtësuar punësimin e grupeve vulnerabël.	Numri i marrëveshjeve të nënshkruara me të paktën 2 biznese lokale për krijimin e mundësive të të rinjve për të mësuar dhe kryer periudha prove	2025	2028		Drejtoria e Juridike dhe Drejtoria e Sherbimeve Sociale	Biznesi lokal
	Totali				1,470,000		

V. MONITORIMI DHE VLERËSIMI

Monitorimi dhe vlerësimi i Planit Social Lokal të Bashkisë Vau Dejës është një proces i vazhdueshëm që synon të sigurojë zbatimin efektiv të masave të parashikuara, matjen e ndikimit të tyre dhe përmirësimin e vazhdueshëm të politikave sociale. Ky proces bazohet në qasje të dhënash të verifikuara, indikatorë të matshëm dhe përfshirjen e aktorëve kyç në analizimin e progresit.

Qasja e Monitorimit

Bashkia Vau Dejës ka përcaktuar një mekanizëm monitorimi të strukturuar, i cili përfshin:

- Indikatorë të qartë matës për vlerësimin e zbatimit të shërbimeve sociale, si numri i përfituesve, përmirësimi i aksesit në shërbime dhe shkalla e realizimit të objektivave të planit.
- Grumbullimin e rregullt të të dhënave nga njësitë administrative, institucionet sociale dhe organizatat partnere.
- Përdorimin e teknologjisë për krijimin e një databaze digjitale që lehtëson monitorimin në kohë reale të shërbimeve sociale.
- Raportime vjetore, të cilat do të analizojnë progresin dhe sfidat në zbatimin e planit.

Procesi i Vlerësimit

Vlerësimi i Planit Social Lokal do të kryhet në dy nivele:

1. Vlerësimi i vazhdueshëm (procesi i monitorimit) – Përfshin analizën e të dhënave mbi ndikimin e politikave sociale dhe shërbimeve në komunitet.
2. Vlerësimi përfundimtar – Pas përfundimit të periudhës së planit, do të bëhet një analizë gjithëpërfshirëse mbi përmbushjen e objektivave dhe ndikimin e politikave të zbatuara.

Ky vlerësim do të ndihmojë në: i) Identifikimin e boshllëqeve dhe përmirësimin e strategjive të ardhshme; ii) Përcaktimin e nevojës për ndryshime në ndarjen e burimeve dhe orientimin e fondeve; iii) Rritjen e transparencës dhe përfshirjen e komunitetit në vlerësimin e politikave sociale.

Përfshirja e Aktorëve Lokalë

Për të siguruar një monitorim dhe vlerësim të besueshëm, në këtë proces do të angazhohen:

- Njësitë administrative dhe sektori i shërbimeve sociale, të cilat do të raportojnë mbi progresin e shërbimeve.
- Organizatat e shoqërisë civile, të cilat do të ndihmojnë në identifikimin e nevojave reale të komunitetit dhe vlerësimin e ndikimit të ndërhyrjeve sociale.
- Komuniteti dhe grupet e interesit, përmes mekanizmave të konsultimit publik dhe feedback-ut mbi efektivitetin e masave të zbatuara.

VI. ANEKSI 1 – TABELAT

Tabela 1

Njësitë administrative	Popullsia Viti 2024 (sipas Rregjistrimit te gjendjec civile
Vau Dejes	13,035
Bushat	24,200
Hajmel	6,300
Vig Mnele	2,177
Temal	2,520
Shllak	1,899
Total	50,131

Tabela 2 Të dhëna mbi numrin e familjeve përfituese të NE në vite

Kategoritë përfituese të NE	Familje perfituese te pageses se NE ne vite		
	2022	2023	2023
Familje përfituese të NE	1,065	1,111	1,036
Individë me status jetimi	1	1	2
Individë viktima të trafikimit	-		
Individë viktima të dhunës	5	3	6
Prindër me më shumë së dy fëmijë të lindur njëherësh			
a) trinjakë			
b) Katënjakë	-	-	-
c) Pesë e më shumë së fëmijë të lindur njëherësh			
Fëmijë të vendosur në familje kujdestare	6	0	5
Fëmijë me aftësi të kufizuar të vendosur në familje kujdestare	-		

Tabela 3 Numri familjeve perfituese të NE sipas Njësive Administrative

Njësia Administrative	Nr familjesh përfituese të NE
Vau Dejes	286
Bushat	170
Hajmel	202
Vig Mnele	111
Temal	133
Shllak	133
Total	1035

Tabela 4 Struktura e familjeve përfituese të NE /Maj 2024

Familje	% T
Me 1 anëtar	1.56%
Me 2 anëtar	20.59%
Me 3 anëtar	16.29%
Me 4 anëtar	24.59%
Me 5 anëtar	23.32%
Me 6 anëtar	9.66%
Mbi 6 anëtar	4.00%

Tabela 5 Struktura e anëtarëve të familjeve përfituese të NE sipas grupmoshës

Grupmosha	Numri personave perfitues te NE
0-15 vjec	724
16-18 vjec	263
19-65 vjec	2023
Mbi 65 vjec	409
Totali	3419

Tabela 6 Të dhëna mbi papunësinë sipas karakteristikave të përgjithshme / Bashkia Vau Dejes 2024

BASHKIA VAU-DEJËS	Grup-mosha	Urban	Rural	Total	Sipas gjinisë		Sipas kategorisë			
					Femra	Meshkuj	PAK	Romë/Egjiptianë	Emigrantë të kthyer	Grafik familjare
	16-19 vjeç	5	5	10	3	7	1	0	0	0
	20-24 vjeç	17	14	31	21	10	1	0	0	0
	25-29 vjeç	13	14	27	16	11	4	0	1	2

	30-39 vjeç	27	9	36	16	20	7	0	0	2
	Mbi 40 vjeç	107	71	178	94	84	6	0	0	12
	Total	169	113	282	150	132	19	0	1	16

Tabela 7 Papunësia sipas nivelit arsimor

BASHKIA VAU DEJËS	Niveli arsimor	Femra	Meshkuj	Total
	Pa arsim	0	0	0
	Fillore	4	7	11
	9-vjeçare	89	87	176
	E mesme e përgjithshme	36	17	53
	E mesme profesionale	5	16	21
	Arsimi Universitar	16	5	21
	Total	150	132	282

Tabela 8 Të dhëna mbi individë të familjeve përfituese të NE të regjistruar si punëkërkues në Zyrën e Punës

BASHKIA VAU DEJËS	NJËSIA ADMINISTRATIVE	Punëkërkues Total	Punëkërkues përfituese të NE (Femra)	Punëkërkues përfitues të NE (Meshkuj)
	Bushat	8	4	4
	Vau Dejës	110	55	55
	Hajmel	2	1	1
	Vig Mnel	1	0	1
	Shllak	1	0	1
	Temal	1	0	1
	Total	123	60	63

Tabela 9 Individë përfitues të pagesës për shkak të Aftësisë së Kufizuar në vite

Kategoria e PAK	Përfitues të Pagesës së AK sipas viteve		
	Viti 2022	Viti 2023	Viti 2024
Para dhe tetraplegjike	53	51	50
Të verbër	123	116	116
Invalidë	465	453	446
PAK të tjerë	660	632	626
Total	1301	1252	1238

Tabela 10 Ndhmësi Personal për PAK

Kategoria e PAK	Numer persona perfitues te pageses per shkak te AK	Numër persona me AK përfitues të Ndhmësit Personal
Para dhe tetraplegjike	50	50
Të verbër	116	41
Invalidë	446	0
PAK të tjerë	626	127
Total	1238	218

Tabela 11

Kategori të PAK	Ndjekin arsimin e mesem sipas viteve			Ndjekin arsimin e larte		
	Viti 2022	Vitit 2023	Viti 2024	Viti 2022	Vitit 2023	Viti 2024
Para dhe tetraplegjike	0	0	0	0	0	0
Të verbër	0	0	0	0	0	0
Invalidë	0	0	0	0	0	0
PAK të tjerë	40	26	13	5	4	2
TOTAL	40	26	13	5	4	2

Tabela 12 Shërbimi i kopshteve publikë në vite

Njesite Administrative	2022-2023		2023-2024	
	Numri i kopshteve	Nr mesatar fëmijësh per vitin	Numri i kopshteve	Nr mesatar fëmijësh per vitin
Bashkia Total	20	528	20	508
Nj.ad Bushat	9	229		224
Nj.ad Vau Dejës	5	172		158
Nj.ad Hajmel	4	116		118
Nj.ad Vig-Mnelë	1	5		2
Nj.ad Temal -Shllak	1	6		6

Tabela 13 Shërbimi publik shkolla 9 vjecare viti 2024 për cdo njësi administrative

Njesitë Administrative	Numri i Shkollave	Nr femijeve total
------------------------	-------------------	-------------------

		Total	F	M
Bashkia total	10	1742	800	942
Nj, Adm Bushat	4	853	414	439
Nj. Adm Vau Dejes	3	544		324
Nj Adm Hajmel	1	292	130	162
NJ Adm Vig -Mnele	1	14	5	9
NJA Adm Temal- Shllak	1	39	19	20

Tabela 14 Shërbimi publik arsimit mesëm viti 2024 për cdo njësi administrative

Njesitë Administrative	Numri i Shkollave	Nr femijeve total		
		Total	F	M
Bashkia total	5	448	205	243
Nj, Adm Bushat	2	229	113	116
Nj. Adm Vau Dejes	2	89	40	49
Nj Adm Hajmel	1	130	59	71
NJ Adm Vig -Mnele	0			
NJA Adm Temal- Shllak	0			

Tabela 15 Asimi profesional

Tabela 16 Situata e rasteve të dhunës

Të dhëna	Raste të dhunës gjatë Vitit 2024
UMM	8
UM	6
Viktima të dhunës sipas gjinisë dhe moshës	0
Gra	10
Fëmijë	1
Të moshuar	1
Burra	0

Karakteristika te viktimave të dhunës mbi 18 vjec				0
	Të papunë			2
	Përfitues të NE			0
	Të Pastrehë			0

Tabela 17 Evidentimi i rasteve të dhunës në Njësitë Administrative

Njesite Administrative	Numri I viktimave te dhunes
Vau Dejes	1
Bushat	4
Hajmel	3
Vig Mnele	0
Temal	0
Shllak	0

Tabela 18 Të moshuar në nevojë

Njësia Administrative	Nr I të moshuarve që jetojnë vetëm dhe që përfitojnë NE			Të moshuar me Ak		
	Total	F	M	Total	F	M
Vau Dejes	140	86	54	12	8	4
Bushat	3	1	2	191	86	105
Hajmel	7	6	1	21	9	12
Vig Mnele	0	0	0	0	0	0
Temal	6	5	1	21	16	5
Shllak	7	5	2	21	16	5
Total	163	103	60	266	135	131